

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7668 E mërkurë 3 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion


Ditës

Tashmë kanë folur të gjithë dhe është më e qartë për këdo se çfarë ka ndodhur. Është një tragjedi me tri akte për vajzën jetime nga një fshat i Fushë-Krujës ...

Vijon në faqen 20

Nga ASTRIT PATOZI

Xhisela i ka mërztur të gjithë



Opinion

Ditës

E diela ishte ters për Maqedoninë, pasi nuk ishte pritur që referendumi për emrin të dështojë, duke mbyllur një shteg të implementimit të Marrëveshjes ...

Vijon në faqen 21

Nga NASER PAJAZITI

Pse dështoi referendumi në Maqedoni?!



Pretenca/ 64 vite për të gjithë bandën

Prokuroria kërkon 17 vite burg për Shullazin, avokati: E diktuar politikisht

Akuza: Grupi i zhvati biznesmenit Ylvi Beqja 500 mijë euro. Ai i kërkoi ndihmë në Hipotekë

TIRANË - Prokuroria e Krimeve të Rënda, pas shtatë seancash gjyqësore dhe dje pretendën për Emiliano Shullazin dhe katër anëtarët e grupit të tij kriminal. Përfaqësuesit e akuzës kërkuan dënimin me 64 vite burg në total për të gjithë anëtarët e bandës. Pretenca është përgatitur nga prokurorët Donika Prella, Besnik Muçi ...

Në faqen 9

DJALI I DEPUTETIT TE PS AKUZOHEP PER PERNDJEKJEN E XHISELA MALOKUT

LIHET NE QELI REXHEP RRAJA: BASHA TA PROVOJE NE VOTIME

Vajza që e denoncoi për dhunë përsërit: Ishte sherr mes të dashuruarish, Rexhepin do ta mbështes. Psikiatri: Ajo po fsheh dhunën nga presioni



(Në foto) Rexhep Rraja dhe në Gjykatën e Krujës. Xhisela Maloku



Në faqet 2-3

PARALAJMERIMI

Rasti "Xhisela", Rama: Shumë shpejt kemi gati paketën kundër shpifjeve

Në faqen 2

UDHEZIMI

Sot nis Lotaria Amerikane, gabimet që nuk duhet të bëni gjatë aplikimit

Në faqen 15

LISTA E PLOTE

Shpallen emrat e 860 mësuesve që do t'i nënshtrohen provimit në tetor

Në faqet 11-13

TEATRI/ FLET KRITIKU

Josif Papagjoni: Shfaqja më e mirë e festivalit kishte regji, por jo aktrim

Në faqet 18-19

APELI: DUA DREJTESI



24-vjeçari nuk i ndaloi policisë: Më plagosën me armë dhe goditën me shkelma

Në faqen 10

DOSSIER/ Letra sekrete e instruktorit të Komitetit Qendror në janar të 1982

"Kunati i Feçor Shehut flet me grekët në Vjenë"

Raporti që denoncon Kadri Hazbiun dhe ministrin e Punëve të Brendshme

NGA DASHNOR KALOÇI

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumba pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazh-



dohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë në mbarë vëndin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutohesh; "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet ...

Në faqet 16-17

DOSJA "XHISELA MALOKU" DESHMITE

Vajza që paditi djalin e deputetit për dhunë ndërron mendje në publik

Xhisela Maloku insiston në rrjetet sociale: Sherr mes të dashuruarish

"Rexhepin do vazhdoj ta mbështes në çdo gjë"

Është kthyer në një çështje të nxehtë rasë ti i Xhisela Malokut. U dhunua apo jo? Iu fik cigare në trup apo jo? Kemi një ekspertizë mjeko-ligjore që thotë po dhe një deklaratë të Xhiselës që e mohon një gjë të tillë. E në këtë tymnajë të madhe, mbështetja ndaj ish-të dashurit të saj duket se është "qershia mbi tortë". Xhisela Maloku parrmbrëmë doli në dy televizionet më të rëndësishme në vend, duke folur në lidhje me denoncimin që ajo ka bërë kundrejt Rexhep Rrajës për dhunë. Në dy intervistat e saj, ajo e ndryshoi versionin të ngjarjen nga çfarë kishite thënë në dëshminë e saj në polici.

Madje, u shpreh se ajo dëshmi është e rremë dhe se e ka bërë për arsye xhelozie. Ndërkohë që sot tregon se pse nuk ishte e pranishme në sallën e gjyqit ku u dha masa ndaj ish-të dashurit të saj që akuzohet për përndjekje, ndërsa thekson se do ta mbështesë atë në çdo gjë.

Përmes një postimi në "Instagram", Xhisela Maloku ka bërë të ditur se i qëndron çdo interviste që ka dhënë, duke i kërkuar nga ana tjetër politikës që të mos fusë hundët.

POSTIMI I PLOTË

"Falënderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur dhe vazhdojnë ta bëjnë. I lutem gjithë opinionit publik për mesazhet negative dhe fyese të ndalen derisa të zbardhet e vërteta. Në lidhje me mospraninë time sot në masën e arrestit për ish-të dashurin, tim dua t'ju sqaroj sepse të pranishëm kanë qenë shumë familjarë të tij dhe prania ime aty do të quhet përsëri kërcënim. I qëndroj çdo interviste që kam dhënë dhe Rexhepin do vazhdoj ta mbështes në çdo gjë. Masa e tij e arrestit ishte e qartë që ishte politike, dimë të gjithë mijëra rase të tilla konfliktesh mes të dashuruarve, por jo të të gjithë janë 'djali i deputetit'. Ai është ish-i dashuri im, nesër mund të jetë miku im, ka mbështetjen time dhe i them që do ia dalë derisa e vërteta të zbardhet siç është dhe politika të mos fusë më hundët. Faleminderit të gjithëve".



Xhisela Maloku

PAKETA ANTI-SHIPJË

Kryeministri Edi Rama, të martën ka paralajmëruar një paketë antishpifje pas akuzave të deputetit të PS, "Më vjen mirë që s'jam më i vetmi që them se vajzën e morën peng dhe e kthyen në mish për topat e kazanit politik e mediatic! Më mirë vonë se kurrë. Ndërkohë, duhet çmontuar me fakte pjesa tjetër e këtij horrori mendjesh e gojësh të përdala. Dhe shumë shpejt një paketë antishpifje", shkruan Rama në "Facebook".



Rexhep Rraja dje në gjykatën e Krujës

U tha se është në mbrojtje, por në shtëpi nuk ka policë

Gjyshi i Xhisela Malokut: Të rinj janë ata, ishalla bashkohen, ta marrë ai

Jashtë banesës ku ka jetuar Xhisela Maloku nuk shihet asnjë patrullë policie, edhe pse prokuroria i ka ofruar mbrojtje 25-vjeçares, kjo e fundit nuk ka pranuar. Në banesën ku ka jetuar e reja ndodhet vetëm gjyshi, Taf Maloku, që tregon për TV "Klan" se si është njohur me rastin e mbesës së tij. "Kam qenë në Itali se isha verbuar nga sytë dhe shkova bëra një operacion. Kam ardhur dhe e kam takuar dhe ç'kam pasur ndonjë lek ua kam çuar, por këtë muhabet s'e kam ditur. Unë tani kam ardhur nga Italia. Politikanët mos të bëjnë grindje njëri me tjetrin. Ndodhi ajo që ndodhi. Unë e falënderoj, as s'e shaj Bashën, as Sali Berishën. Kanë marrë vesh për një qëllim dhe kanë thënë që është jetime. Mirëpo tani të rinjtë nuk e di se ç'bëjnë. Ishalla bashkohen ta marrin, se s'është punë burgu. Burgu s'është asnjë gjë se s'ka vrasë njeri. As ai s'ka vrasë njeri, as goça ime



Gjyshi i Xhisela Malokut

FAMILJARET

Familja Maloku është përballur me disa fatkeqësi. Babai i Xhiselës ka mbetur i vrarë në vitin 1997. Gjyshi i Xhiselës tregon se kjo është një çështje mes të rinjsh dhe i bën apel politikës të qëndrojë larg.

s'ka vrasë njeri. Janë ngatërruar, se janë duke harruar të mëdhenjtë". Xhisela Maloku ka denoncuar për dhunë ish-të dashurin e saj, Rexhep Rraja, që do të qën-

drojë në burg për akuzën e përndjekjes. 25-vjeçarja publikisht ka mohuar se ndaj saj është ushtruar dhunë dhe kallëzimet i ka bërë për shaka xhelozie.

POLICI

Emiljano Nuhu: Më thanë "do të zhdukim, hiq dorë"


Më 30 korrik 2018, oficeri i policisë Emiljano Nuhu kallëzoi në polici se u kërcënuar nga Redjan dhe Ramazan Rraja, nipër të deputetit të PS, Rrahman Rraja. Emiljano Nuhu dha detaje në polici në lidhje me bisedën e bërë në lokalit "Rich Mond", ku ndodhi takimi mes tyre. Oficeri Nuhu pretendon se kushërinjtë Rraja e kanë kërcënuar me jetë duke i thënë se nëse nuk heq dorë nga hetimi i çështjes së Xhiselës, do ta zhdukim brenda 24 orëve. Ish-oficeri Emiljano Nuhu ndodhet në një nga vendet e BE-së pas intervistës së tij, ku shprehet se i ishte vënë pistoleta në kokë, në prani të deputetit Taulant Balla dhe Rrahman Rraja për çështjen "Xhisela", ku ishte i përfshirë djali i Rrajës. Djali i deputetit socialist Rrahman Rraja akuzohet për dhunim e ish-të dashurës Xhisela Maloku. Rexhep Rraja u arrestua dje pas urdhrat të Gjykatës së Krujës, e cila ka dhënë "Arrest me burg" në mungesë për të riun e akuzuar për dhunim e Xhisela Malokut. Vendimi i gjykatës vjen edhe pas administrimit të aktit të ekspertizës për të renë e dhunuar dhe e torturuar nga Rraja. Ai është dërguar në ambientet e Drejtorisë së Policisë Durrës.





A U FSHEH DHUNA?

"Në rast se marrim të mirëqenë të gjitha denoncimet, është e qartë si drita e diellit se tani ajo është e dhunuar dhe po e fsheh atë, si pasojë e një presioni të vazhdueshëm mbi të nga disa persona, jo vetëm nga ish-i dashuri i saj. Bërja publik e këtij rasti jep mundësinë për të ndërhyrë, për të bërë ndryshime, për t'u marrë masa", tha Demi.



DESHMIA E XHISELES

"Pavarësisht se unë i kam thënë që nuk doja të vazhdoja lidhjen me të, por unë jam kthyer përsëri tek ai edhe për shkak të frikës, edhe për shkak të dëshirës sime. Sikundër e theksova më sipër, ndarja ime përfundimtare me të ka qenë në muajin korrik 2018", ka thënë Xhisela në deponimin e parë në prokurori.

Ekspertiza mjeko-ligjore vërteton dhunimin e ndaj ish-të dashurës

Djali i deputetit të PS mbetet në qeli: Basha ta provojë në votime

Rexhep Rraja do të gjykohet për "përndjekje"

LIDHJA

Shtetasi Rexhep Rraja prej disa vitesh ka qenë në një raport dashurie me viktimën Xhisela Maloku. Palët janë njohur para shtatë vitesh në komunën Nikël të qytetit të Krujës dhe mes tyre ka pasur një raport intensiv lidhje dashurie.




"Barra për të sqaruar këto gjëra nuk i takon asaj"

Psikiatri Neli Demi: Xhisela Maloku nuk është në gjendje të sqarojë të vërtetën

Psikiatri Neli Demi bëri dje një analizë prej specialis ti të gjendjes së Xhisela Malokut në intervistat televizive. Dje në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në "News 24" ishte i ftuar psikiatri, sipas të cilit, vajza e dhunuar nga djali i deputetit të Partisë Socialiste nuk është ende në gjendje për të sqaruar publikun në lidhje me atë që ka ndodhur. Nga denoncimet e bëra nga vetë Xhisela, sipas Demit është e qartë si drita e diellit se ndaj saj është ushtruar dhunë e vazhdueshme. Por, përgjigjet e vajzës janë dhënë nën një presion të vazhdueshëm nga shumë persona - thotë psikiatri - e për këtë arsye asaj i duhet krijuar një ambient sa më protektiv. "Vajza nuk është në gjendje t'i shërbejë publikut për këtë fenomen që ka tërhequr publikun, pasi barra për të sqaruar këto gjëra nuk i takon asaj. Ajo dhe familja e saj duhet të merret në mbrojtje për të krijuar një ambient që të lehtësojë gjendjen psikologjike të vajzës. U bënë shumë analiza për përgjigjet kontradiktore, por nuk është çudi kur je brenda ciklit të dhunës, se bëhen edhe për të mbrojtur veten pas frikës ekstreme. Vura re te Xhisela një presion të jashtëzakonshëm nga gjuha e saj trupore. Thashë që ka nevojë për ekzaminim të hollësishtëm, që duhet të ishte një nga hapat e parë për të krijuar ambient të sigurt për personin. Nëse këto hapa nuk ndërmerrren, nuk shoh ndonjë prishmëri pozitive lidhur me gjendjen e saj psikologjike".

Gjykata e Krujës ka dhënë masën e sig urisë "arrest me burg" për djalin e deputetit Rrahman Rraja, Rexhep Rraja. Ky i fundit doli dje para gjykatës së Krujës për t'u njohur me masën e sig urisë, pas akuzave për dhunë fizike ndaj ish-të dashurës së tij, Xhisela Maloku.

Ai ka dalë nga paraburgimi i shoqëruar nga efektivi, ndërkohë që te dera e priste furgoni i policisë. Rexhep Rraja u arrestua pak ditë më parë pas urdhrorit të gjykatës së Krujës, e cila ka dhënë "Arrest me burg" në mungesë për të riun e akuzuar për "përndjekjen" e Xhisela Malokut. Ndonëse ndaj tij është ngritur vetëm akuzat e "Përndjekjes", ekspertiza mjeko-ligjore tregoi se 25-vjeçarja ishte dhunuar. Dhunimi i vajzës u bë publik pak ditë më parë, kur oficeri i policisë Emiljano Nuhu dëshmoi për dhunën e ushtruar ndaj vajzës së re dhe akuzoi policinë për neglizhencë si dhe tregoi se ishte kërcënuar me armë në prani të deputetit Taulant Balla. Pas daljes nga gjykata, Rexhep Rraja ka dhënë një prononcim të shkurtër për mediat, ku kishte edhe një mesazh për kreun e PD, Lulzim Basha. Sipas, djali i deputetit, arrestimi i tij ka ardhur si pasojë e politizimit të çështjes. "Lulzim Basha ta provojë në votime", - ka thënë Rraja pas daljes nga gjykata e Krujës. Rexhep Rraja u arrestua pak ditë më parë pas urdhrorit të gjykatës së Krujës, e cila ka dhënë "Arrest me burg" në mungesë për të riun e akuzuar për "përndjekjen" e Xhisela Malokut. Ndonëse ndaj tij është ngritur vetëm



akuzat e "përndjekjes", ekspertiza mjeko-ligjore tregoi se 25-vjeçarja ishte dhunuar. **DOSHJA E PROKURORISE** Në kërkesën e Prokurorisë së Krujës për caktimin

masës "Arrest me burg" ndaj djalit të deputetit socialist të Fushë-Krujës, Rrahman Rraja, zbulohet se ky i fundit e ka kërcënuar me jetë vajzën. Kërkesa për masën e sigurisë është fir-

mosur më 29 shtator 2018 nga prokurorja Mirela Kapo referuar materialeve të përcjella nga policia e Krujës që më 23 shtator 2018. "Shtetasi Rexhep Rraja prej disa vitesh ka qenë në një raport dashurie me viktimën Xhisela Maloku. Palët janë njohur para shtatë vitesh në komunën Nikël të qytetit të Krujës dhe mes tyre ka pasur një raport intensiv lidhje dashurie. Konkretisht, shtetasja Xhisela Maloku me banim në komunën Nikël të qytetit të Krujës, fillimisht në datën 21.07.2018, pranë komisariatit numër tre të qytetit të Tiranës, ka kallëzuar faktin se në mënyrë të përsëritur, në episode të përsëritura dhe prej një viti përndiqet nga ana e shtetasit Rexhep Rraja. Në datën 21.07.2018 përpara oficerit të policisë gjyqësore në stacionin e Fushë-Krujës, shtetasja Xhisela Maloku është shprehur se ka ardhur pranë këtyre ambienteve, me qëllim që të tërheqë kallëzimin e bërë pranë komisariatit nr. tre Tiranë pasi gjithçka është bërë për motive xhelozie. Po në datën 21.07.2018 sikundër rezultojn nga aktet e procedurimit penal nr.371 të vitit 2018 në ngarkim të oficerit të policisë gjyqësore Gentian Çitozi është regjistruar procedimi penal për veprën penale të parashikuar nga neni 248 atë të "Shpërdorimit të detyrës" lidhur me veprimet e paligjshme dhe trajtimin preferencial në ngarkim të të hetuarit Rexhep Rraja. Gjithashtu, rezultojn se faktet e referuara nga ana e oficerit të policisë gjyqësore janë referuar në mënyrë të cunguar, me qëllim lehtësimin e pozitës procedurale të shtetasit Rexhep Rraja.

SKANDALI AKUZAT

Kreu i PD: Djali i deputetit para se të bëhej përdhunues vajzash, ka dhunuar zgjedhjet

"Ta provoje në zgjedhje", Basha i përgjigjet Rrajës: Hajdut i votave

"Pushteti i Ramës e mbrojti para drejtësisë"

Valentina Madani

Kryetari i PD, Lulzim Basha, akuzoi dje Rexhep Rrajën, djalin e deputetit socialist si përdhunues dhe dhunues zgjedhës. Z.Basha reagoi dje publikisht pas reagimit të Rexhep Rrajës, i akuzuar për përndjekjen e ish-të dashurës së tij, Xhisela Malokut, akuzë për të cilën Gjykata e Krutës e la në burg. Nga reagimi, Rraja duket sikur akuzonte Bashën për politizimin e çështjes së tij teksa e kërcënoi se "le ta provonte në zgjedhje". Në reagimin e tij, kryedemokratia e quan Rrajën përdhunues dhe shprehet se para se të bënte këtë, ishte i angazhuar në vjedhjen e zgjedhjeve. Sipas tij, Rraja ka vjedhur zgjedhjet për të sjellë në pushtet Ramën. "Para se të kthehej në përdhunues dhe torturues vajzash, Rexhep Rraja ishte dhunues zgjedhës. Rexhep Rraja dhe kriminelët e tjerë sollën në pushtet Edi Ramën dhe pushteti i Edi Ramës e mbrojti atë nga dalja para drejtësisë për vjedhjen e votave. Pushteti që i ati dhe Edi Rama mbajnë me votat e vjedhura, e mbrojtën Rexhepin edhe kur përdhunoj", - deklaroi Z.Basha. Kreu i PD-së përmendi se ishte denoncimi dhe presioni i shoqërisë dhe opozitës që e çuan Rexhepin në sallën e gjyqit. "Prandaj Rexhepi është i habitur që ndodhet atje dhe kërcënon se do hakmerret kundër opozitës, duke i vjedhur prapë zgjedhjet. Sepse Rexhepi e di mirë se kur vjedh zgjedhjet, je zot që mund të bësh çfarë të duash, të grabisësh, të përdhunosh, të vrasësh. Që Rexhepi të mos dhunojë më, duhet që Edi Rama të mos ketë më pushtet!", - u shpreh kreu i PD-së. Lulzim Basha komentoi më herët intervistat e Xhisela Malokut për mediat, vajza e cila denoncoi në polici të dashurin e saj Rexhep Rraja, djali i deputetit socialist Rrahman Rraja, për ushtrim dhune. Në një postim në 'FB', Basha u shpreh se është tronditëse të shohësh një të mbijetuar të përdhunimit



Kryetari i PD, Lulzim Basha

Bylykbashi: Rraja zëdhënës i PS për zgjedhjet, kërcënon opozitën

Deputeti i PD, Oerd Bylykbashi reagoi dje pas deklarës së djalit të deputetit të PS, Rrahman Rraja nga ambientet e gjykatës së Krutës, teksa tha se: "Basha do ta shohë në votime". Deputeti i PD shprehet se Rexhep Rraja është zëdhënës i PS për zgjedhjet dhe kërcënon opozitën. "Zëdhënës dhe prove më të mirë të paktit të PS me kriminelin për të dhunuar zgjedhjet nuk ka! Kjo është reforma që propozon PS!", - thotë Bylykbashi. "Rexhep Rrahja - zëdhënës i PS për zgjedhjet, PS e paska gjetur konsensusin për reformën zgjedhore. PS deklaroi se do të bëjë propozimet e saj të njëanshme për Kodin zgjedhës."



hor. Arsyeja është shumë e thjeshtë: po sot, nën pranga për dhunimin e një vajze të pafajshme, i biri i Rrahman Rrahjes kërcënon opozitën: do ta shihni në zgjedhje.

dhe të dhunës të mohojë përdhunimin dhe torturën për të mbetur gjallë. Sipas Bashës, "Xhisela e di shumë mirë se çfarë kriminelësh gjakftohtë dhe të pamëshirshëm janë ata, ai që e përdhunoj dhe ata që e mbrojnë përdhunuesin, ndaj ajo bëri atë që bëni çdo njeri i tmerruar që kërkon të mbijetojë: mbrojti veten dhe familjen e saj". Kreu demokrat shprehet se Rrah-

man Rraja është pjesë e një prej bandave kriminale që sundojnë dhe terrorizojnë Shqipërinë. "Xhisela e di shumë mirë se çfarë kriminelësh gjakftohtë dhe të pamëshirshëm janë ata, ai që e përdhunoj dhe ata që e mbrojnë përdhunuesin, ndaj ajo bëri atë që bëni çdo njeri i tmerruar që kërkon të mbijetojë: mbrojti veten dhe familjen e saj", theksoi Z.Basha. Për kreun e PD, sot

“KLEVIS BALLIU "Edhe pse me pranga duar, Rexhepi kërcënon duke thënë se do të shihemi në votime. Këtë kurajë Rexhepi e merr nga Edvin Kristaq Rama. Rexhepi tashmë i certifikuar si dhunues dhe përdhunues mund të jetë sot një aset kryesor për Rilindjen në zgjedhje", tha deputeti i PD.

Zëdhënës dhe prove më të mirë të paktit të PS-së me kriminelin për të dhunuar zgjedhjet nuk ka! Kjo është reforma që propozon PS!", deklaroi Z. Bylykbashi. Në Shqipëri nuk ka më drejtësi. "Rrahman Rrahja është pjesë e një prej bandave kriminale që sundojnë dhe terrorizojnë Shqipërinë. Sot në Shqipëri nuk ka më as polici, as prokurori, as drejtësi, as parlament. Parlamenti dhe drejtësia kanë rënë dhe në vend të tyre sundon banda e Ramës, Rrahajve, Habilajve, Bajrëve, Shullazëve me shokë", - deklaroi kreu i opozitës.



Protesta e djeshme në Mengel

JOZEFINA TOPALLI

Zj.Topalli shkruan në 'FB' se, "askush prej nesh nuk e di sesa net pa gjumë ka kaluar Xhisela, në një fshat të dominuar nga bandat, ku nuk mund të hyjë as policia dhe kundërshton të gjithë ata 'trima', që i lejojnë vetes të gjykojnë Xhiselën, sa kohë ajo e bën për të mbrojtur jetën e nënës dhe të motrës së saj".

PD, letër ambasadorit të BE: Siguroj azil për Xhiselën

PD përmes zëdhënësës Ina Zhupa i dërgoi dje një kërkesë ambasadorit të BE-së në Shqipëri Luigi Soreca, ku kërkohej që vendet e BE t'i sigurojnë azil Xhisela Malokut, e dhunuar nga ish-i dashuri i saj, djali i deputetit socialist, Rrahman Rraja. Në letër PD shprehet se në këtë rast dhune duket qartë përfshirja e shtetit dhe presioni i madh politik mbi çështjen. "Në standardet më minimale europiane fytyra e vajzës nuk duhet të ishte shfaqur në TV kombëtare. Por në fakt fytyra e saj tregonte qartë dhunën, shantazhin dhe frikën e saj. Dje në të vërtetë nuk pamë Xhiselën, por ishte fytyra e vërtetë e pushtetit të sotëm, e parlamentit, e policisë dhe e prokurorisë. Dje ata konsumuar aktin e fundit të trajtimit çnjerëzor të vajzës së dhunuar. Xhisela Maloku mendoj se është detyruar të dalë në media dhe të pranojë që ka mashtruar në dëshminë e parë, që është vetëdhunuar; të gjitha deklaratime që sipas avokateve penalistë ndodhin shpesh kur vajzat e dhunuar janë në presion dhe nën frikën për jetën", - thuhet në letrën e dërguar ambasadorit të BE në Tiranë.



Duma: Xhisela, e marrë peng nga bandat e Edi Ramës Rrëfimet e Xhisela Malokut dhënë për mediat, sipas PD janë pjesë e skenarit të kryeministrit Edi Rama për të shfaqur përdhunuesit dhe torturuesit në pushtet. Për opozitën, 25-vjeçarja e dhunuar nga djali i deputetit socialist Rrahman Rraja është marrë peng nga bandat e qeverisë. "Të gjithë pamë mbrëmë se si krimi në pushtet tregoi fuqinë e vetë të egër, kur detyroi vajzën, viktimit të përdhunimit nga djali i një deputeti, të akuzonte të flijonte veten, duke shfaqur kë? Duke shfaqur përdhunuesit dhe torturuesit me pushtet. Të gjithë u bëmë dëshmitarë sesa i pamëshirshëm është skenari i Edi Ramës për të sakrifikuar një vajzë të marrë peng nga bandat e tij, në mënyrë që t'u garantojë paprekshmëri këtyre banditëve që i sigurojnë pushtetin në Krutë dhe Fushë Krutë", deklaroi deputetja e PD-së.



Tensionohet protesta për shkollën, lirohet pas 6 orësh rruga Elbasan-Librazhd

Protesta në Mengël degjeneron në dhunë, policia gjakos fëmijët

Fëmijët kërkojnë rihapjen e shkollës në Mengël

Valentina Madani

Nxënësit e shkollës së fshatit Mengël të La binotit në Elbasan, bojkotuan mësimin ditën e djeshme dhe bashkë me prindërit e tyre protestuan kundër largimit të shkollës ku janë aktualisht. Prindër dhe nxënës të këtij fshati përshkallëzua protestën kundër mbylljes së shkollës. Protesta degjeneroi në dhunë fizike edhe mbi fëmijët të cilët të traumatizuar, u shprehën mes lotësh se janë goditur nga Forcat Speciale. 'Më gjuajtën policët te koka!' dëgjohej të thotë një djalë i vogël, me lot në sy. Protestuesit për afro 6 orë bllokuan rrugën dhe kërkuan që të mos transferohen në shkollë tjetër, pasi sipas tyre do u prishet shkolla që kanë. Edhe pse kishin deklaruar se do e hapnin rrugën në orën 16:00, protestuesit kanë pranuar të tërhiqnin rreth orës 18:00. Por protesta e prindërve dhe fëmijëve të shkollës 9-vjeçare në Mengël të Elbasanit, të cilët kërkojnë hapjen e shkollës së tyre, e dëmtuar nga tërmeti para një viti u shoqërua me tensione dhe përplasje fizike protestuesve të largohen nga rruga, pasi po u krijohet probleme serioze përdoruesve të rrugës.



Një nga fëmijët e dhunuar nga policia në protestën e djeshme në Mengël

THIRRJA

Policia e Elbasanit u bëri thirrje qytetarëve me megafon për evitim të incidenteve. Për shkak të protestës për shkollën në Mengël të Elbasanit, u krijua kaos dhe u bllokua trafiku. Për këtë arsye policia u bëri thirrje drejtuesve të mjeteve dhe pasagjerëve të qëndrojnë në mjetet e tyre deri në hapjen e rrugës. Policia kërkoi mirëkuptimin e përdoruesve të rrugës për shkak të situatës së krijuar nga protesta. Forcat e rendit u kërkuan protestuesve të largohen nga rruga, pasi po u krijohet probleme serioze përdoruesve të rrugës.



Boçi goditet nga policia, LSI: Shteti i dhunës

Në protestën e djeshme në Mengël të Elbasanit mori pjesë edhe deputeti i PD, Luçiano Boçi, i cili është përplasar me forcat e policisë. Protesta degjeneroi në dhunë ndërsa mësohet se është goditur edhe deputeti demokrat Luçiano Boçi. Edhe deputetja e LSI-së Floida Kërpaçi u bashkuar protestës për shkollën në Mengël të Elbasanit. 'Ky është shteti i dhunës', tha Kërpaçi. Sipas saj, policia ka dhunua fëmijët. 'Forcat Speciale të policisë kanë dhunuar fëmijët. Kërkesa e banoreve është legjitime', shprehet deputetja e LSI-së, Floida Kërpaçi.

Balla: PD nuk kursen as fëmijët për të bërë politikë

Kreu i deputetëve të PS-së, Taulant Balla akuzoi dje se "PD po përdor fëmijët dhe prindërit në Mengël të Elbasanit, për të bërë politikë". Balla tha se "nuk ka turp më të madh për politikën kur përdor edhe jetën e fëmijëve si mish për top në luftën politike". Ai bëri të ditur se "ditën e mërkurë fillojnë punimet e rikonstruksionit të shkollës në Mengël të Elbasanit, sepse shkolla është e dëmtuar dhe në kushtet që është rrezikon seriozisht të shembet dhe të zërë fëmijë e mësues brenda. Fillon të mërkurën, sepse procedurat e tenderimeve publike kërkuan kohën e vet minimale". Balla shpreh habinë "pse politika e zymtë e PD, një partie që ka humbur toruan, pa ekip, pa program, pa lidhshmëri, me ca militantë të papërgjegjshëm duan të luajnë me jetët e fëmijëve? "Duam të bëjmë mësim në shkollën që po shembet. Nuk duam rikonstruksionin. Nuk i çojmë fëmijët 1 muaj në një shkollë tjetër". Më thoni si mund t'ua zgjidhësh këtë kërkesë pa kuptim. Kur brenda disa ditësh shkolla do të ketë kolona të reja mbajtëse dhe vetëm atëherë mund të zhvillohet mësimi normalisht".

për të negociuar. Gjithashtu, Drejtori i policisë, Altin Qato është takuar me deputetin e PD Luçiano Boçi. Në vendngjarje ishin forca të shumtë policie dhe qytetarë, që protestonin, por dhe shumë makina mbetën të bllokua. Nxënësve iu duhet të udhëtojnë çdo ditë për në qytetin e Elbasanit për të ndjekur mësimin për shkak se shkollën, ndërsa protestojnë bashkë me prindërit për hapjen e shkollës së fshatit. Sipas specialistëve, shkolla e Mengëlit ka nevojë për rikonstruksion forues të strukturave pasi rrezikon të shembet. Në të tillë situatë nxënësve u është siguruar transporti falas deri në shkollat e qytetit, por rreth 200 nxënës e kanë bojkotuar.

PROTESTA

Protesta e prindërve dhe fëmijëve të shkollës 9-vjeçare në Mengël të Elbasanit u shoqërua me tensione dhe përplasje fizike. Ata kërkojnë hapjen e shkollës së tyre, e dëmtuar nga tërmeti para një viti. Pas 6 orësh, protesta në Elbasan, pas thirrjeve nga policia, banorët liruan rrugën duke zhblokuar kështu trafikun.



Zyrtari i Merkelit takon Palokën e Spahon: Gjermania mbështet vetingu në politikë

Nënkryetarët e Partisë Demokratike, Edi Paloka dhe Edmond Spaho pritën dje në selinë e PD-së Sekretarin e Shtetit në Ministrinë e Brendshme Federale të Gjermanisë, Stephan Mayer. Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka shkruan në faqen e tij në 'Facebook' se Mayer u shpreh se 'vetingu në politikë është i rëndësishëm'. Takim me Sekretarin e Shtetit në Ministrinë e Brendshme Federale të Gjermanisë Stephan Mayer. Mayer: 'Vetingu në politikë, shumë i rëndësishëm'. Në selinë e PD bashkë me z. Spaho zhvilluam një takim me z. Stephan Mayer, deputet në Bundestag dhe Sekretar Shteti në Ministrinë e Brendshme Federale të Gjermanisë. Lidhur me kërkesën e opozitës për veting të politikanëve z. Mayer u shpreh qartë: 'Vetingu në politikë është shumë i rëndësishëm, kështu merr kuptim dhe vetingu në organet e drejtësisë...'. shprehet z. Paloka.

VETINGU

Lidhur me kërkesën e opozitës për veting të politikanëve z. Mayer u shpreh qartë: "Vetingu në politikë është shumë i rëndësishëm, kështu merr kuptim dhe vetingu në organet e drejtësisë...".

Presidenti takon senatorin republikan Roy Blunt: SHBA, partneri ynë strategjik

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta u prit në Uashington, në Senat, në një takim të veçantë nga senatori Roy Blunt, zëvendësryetar i Konferencës të Senatorëve Republikanë. "SHBA-të - theksoi Presidenti Meta - janë partneri ynë strategjik, ndaj forcimi i mëtejshëm i këtyre marrëdhënieve është një rëndësi vitale për ne. Angazhimi i SHBA në rajonin tonë mbetet kyç edhe për të ardhmen, në mënyrë që të konsolidohen arritjet e deritanishme si në drejtimit të stabilitetit e sigurisë, ashtu edhe të përparimit të demokracisë e prosperitetit. Ndaj ne mbështesim fuqishëm politikën e dyerve të hapura të NATO-s dhe pas anëtarësimit të Malit të Zi, vlerësojmë se edhe anëtarësimi i Maqedonisë në NATO do të ishte një arritje tepër pozitive për të ardhmen e të gjithë rajonit tonë", tha Meta. Presidenti i Republikës, Ilir Meta gjatë vizitës së tij në Uashington D.C mbajti një ligjëratë si i Ftuar Nderi i Qendrës së

Ilir Meta në Uashington: Ndryshimi i kufijve hap "Kutinë e Pandorës"

"Referendumi në Maqedoni të shërbejë si sinjal zgjimi"



Presidenti i Republikës, Ilir Meta, gjatë vizitës së tij në Uashington

sishme që po ndodhin në të njëjtën kohë, si dhe me procese të hapura integruese në NATO dhe në Bashkimin Europian. Ballkani mbetet ende një punë e papërfunduar". "Dua të theksoj faktin se ndërhyrja e NATO-s dhe veçanërisht përfshirja e SHBA-ve dhe

ajo e mëvonshme e BE-së ishin jetësore për Ballkanin atëherë, siç janë domethënëse e të lidhura me të edhe tani", theksoi Presidenti i vendit. Meta u shpreh se, "faktorit shqiptar ka qenë dhe vazhdon të jetë një katalizator jetik për ta zgjeruar hapësirën

e kufijve të NATO-s dhe BE-së në këtë rajon, pasi NATO-ja dhe BE-ja mbeten bazat e qëndrueshmërisë në Ballkanin Perëndimor". Duke folur për referendumin në Maqedoni, Meta u shpreh: "Ai duhet të shërbejë si një sinjal zgjimi, duke na rikujtuar se edhe marrëveshjet më të mira të mundshme e me mbështetje të gjerë dhe të gjerë ndërkombëtare, nuk janë edhe aq të lehta për t'u zbatuar në një kontekst të ndërlikuar.

Shpresoj se edhe kjo marrëveshje do të gjejë rrugën e saj në Parlamentin maqedonas dhe do t'i hapë Maqedonisë dyert për në NATO dhe BE. Gjithashtu, e vlerësoj faktin se ata që morën pjesë në këtë referendum, mbështetën qartazi këtë rrugë duke votuar në favor të kësaj marrëveshjeje", tha më tej Meta. "Propozimi më i fundit për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi është kohë e çuar dëm. Do përbënte çelësin e hapjes së Kutisë së Pandorës, në kuptimin më të keq të saj. E paimagjinueshme që dialogu Kosovë-Serbi të prodhojë një marrëveshje, e cila do ndryshonte kufijtë sipas vijave etnike", tha Presidenti. "Më e rëndësishmja është t'u japim të rinjve mesazhin e sigurisë për të ardhmen e tyre, gjë që vjen dhe mund të bëhet e mundur vetëm nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit, marrëdhënieve të mira fqinjësore, si dhe bashkëjetesës ndëretnike dhe respektimit të pakicave kombëtare", u shpreh Meta.

EUROBOND


Rama: Tregjet u përgjigjen falë reformave
Ahmetaj: Nuk ka rritje të borxhit publik

Shqipëria emetoi dje për herë të parë një eurobond me afat 7-vjeçar në tregjet ndërkombëtare, përmes të cilit qeveria mori 500 milionë euro hua. Ankandi, i konsideruar si një test i rëndësishëm për kredibilitetin e ekonomisë shqiptare, ka përfunduar. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj tha se me këtë eurobond bëhet i mundur "zëvendësimi i një borxhi të mëparshëm me të shtrenjtë, me një instrument më të lirë dhe më afatgjatë. Tregjet testuan ekonominë shqiptare dhe reformat. Reformat e guximshme dhe të domosdoshme janë duke na shpërblyer. Shqipëria bëhet një vend normal, ku mund të investohet pa frikë dhe në periudhë afatgjatë", theksoi Ahmetaj. Sipas tij, "nuk do të ketë rritje të borxhit publik". Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama tha: "Tregjet u përgjigjen qartë, 4 vjet më parë Shqipëria paguante 5.75% bond 5-vjeçar, që të kompensoi ata që investonin paratë tek ky vend. Sot paguajmë 3.5% bond 7-vjeçar, Shqipëria shihet si një investim i sigurt e premtues falë reformave transformuese. Ende shumë për të bërë".

Kryebashkiaku i Fierit dhe ambasadorja e Kinës, vizitë në ambientet e kompanisë

"Bankers', vitin e ardhshëm më shumë investime e projekte në komunitet"

Ambasadorja e Kinës, Jiang Yu dhe kryetari i Bashkisë së Fierit, Armando Subashi, zhvilluan një vizitë zyrtare në ambientet e kompanisë më të madhe të naftës, "Bankers Petroleum". Kompania, e cila operon për më shumë se 15 vitesh në fushën e naftës së Patos-Marinzës, që nga viti 2016 është blerë nga kompania kineze "Geo-Jade". Gjatë bisedës, drejtori ekzekutiv i "Bankers", Xingyun Sun konfirmoi se aksionerët e rinj të kompanisë kanë plane ambicioze për kompaninë dhe prandaj për vitin e ardhshëm investimet do të rriten ndjeshëm. "Për vitin e ardhshëm ne kemi planifikuar mbi 150 milionë dollarë amerikanë investime, që do të thotë më shumë prodhim, më shumë të ardhura për ne, por edhe për qeverinë lokale dhe qendrore", tha zoti Sun. Ambasadorja e Kinës vlerësoi bashkëpunimin institucional midis kompanisë e bashkisë dhe theksoi se kjo marrëdhënie do të intensifikohet në të ardhmen. Zonja Ju theksoi se investimet kineze në Shqipëri do të rriten dhe "Bankers" është një shembull i qartë që tregon seriozitetin dhe



AMBASADORI KINEZ

"Rritja e investimeve nuk mund të bëhet pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e të gjithë aktorëve, qeverisë lokale dhe qendrore, komunitetit dhe opinionit publik", tha ambasadorja e Kinës.

ndikimin e rëndësishëm që kanë këto kapitale në vend. Ndërkohë, kryetari i Bashkisë së Fierit, Armando Subashi konfirmoi mbështetjen e tij për bashkëpunimin e mëtejshëm, qoftë në investime në komunitet dhe rajonin e Fierit, por edhe në zgjerimin e mëtejshëm të kompanisë. "Ne e vlerësojmë shumë 'Bankers'-in si një

partner të suksesshëm për rajonin tonë, duke qenë tatimpaguesi më i madh që kemi. Jam shumë mirënjohës, sepse edhe në kohët më të vështira që kjo kompani ka hasur, nuk ka pasur vonesa në pagesat e taksave vendore, duke qenë kështu një nga partnerët më seriozë që kemi", tha z. Subashi.

Mazhoranca do të propozojë më 8 tetor draftin e saj, PD bojkoton

Çuçi: Do kryejmë detyrimet tona, reforma zgjedhore nuk ka vdekur

Mungesa e opozitës në punimet e Kuvendit duket se po sjell edhe dështimin e reformës zgjedhore. Socialistët pritet të paraqesin një draft të tyrin për ndryshimet në ligjin zgjedhore, ndërsa opozita e ka cilësuar këtë të njëanshme. Bashkëkryetari i komisionit të reformës zgjedhore, socialisti Bledi Çuçi tha dje se shpresonte që PD të rikthehej në tryezë. "Javën e ardhshme prezantojmë draftin e propozimeve për reformën zgjedhore. Drafti do t'u dorëzohet të gjitha partive parlamentare. Drafti përfshin kërkesat dhe rekomandimet e bëra. Në draft kanë kontribut edhe ekspertët gjermanë", u shpreh Çuçi. Drafti është hartuar nga dy ekspertë, Viktor Gumi i cili është i PS-së dhe Ilir Rusmali i PD-së, të cilët prej gushtit kanë përkthyer në amendamente vullnetin e partive politike për reformimin e ligjit elektoral. Por



prezantimi i draftit përveç shprehjes se vullnetit për realizimin e reformës, nuk sjell asgjë konkrete, pasi duhen 84 vota dhe konsensusi i demokrateve për ta miratuar. "Shpresoj që edhe opozita të vijë dhe të bëhet pjesë e këtij procesi deri në fund. Ne si mazhorancë do kryejmë detyrimet dhe përgjegjësinë tonë që kemi përpara shqiptarëve. Reforma nuk ka vdekur ende", tha më tej Bledi Çuçi, duke

shpresuar në rikthimin e PD-së në Kuvend. Palët kanë rëndë dakord për kërkesat kryesore, siç është pranimi i votimit dhe identifikimit elektronik siç kërkoi PD, si dhe votën e emigrantëve për vitin 2021 siç kërkoi PS. Socialistët nuk kanë ndërmend të presin më, por në 8 tetor do të publikojnë amendamentet e tyre të përgatitura nga eksperti Viktor Gumi.

Nga 1 janari i vitit të ardhshëm, rritje e akcizës së duhanit. Pritet fjala e bizneseve

Voltiza Duro

Paketa fiskale 2019, pritët të ulet tatimi mbi pagat. Sot nis konsultimi

Propozimi i qeverisë: Ulje e tatimit në 18%

Gjatë mbledhjes së sotme të Këshillit Kon-sultativ, pritët që biz-nesi të propozojë uljen e ta-timit mbi pagat e larta nga 23 përqind që ishte më parë në 18 përqind. Që prej kohës së ardhjes në pushtet të qeverisë "Rama" në 2013-ën, u vendos heqja e taksimit të sheshtë mbi pagat prej 10 përqind dhe vendosjen e tatim-it progresiv me sloganin "kush fiton më shumë, paguan më shumë", duke bërë që rrogat e larta mbi 130 mijë lekë të taksoheshin 23 përqind. Por mesa duket edhe kjo politikë do të ketë sërish tërheqje. Ministria e Financave pritët të ndërhyjë në 5 ligje për paketën e re fiskale si ligji për procedurat tatimore, për tatimin mbi vlerën e shtuar, për akcizat, për tatimin mbi të ardhurat dhe ligji për taksat nacionale. Për këtë arsye, kjo ministri i ka dërguar biz-nesëve pikat kryesore të drafteve që pritët të rishikohen. Ndër ndryshimet janë ulja e dividendit që aplikohet të korporatat. Aktualisht ky tatim paguhet në masën 15%, por qeveria ka propo-zuar ta ulë në 10%. Gjith-ashtu, dhe rishikimi i kufijve të pagës që tatohen

RRITJE E AKCIZËS

Nga 1 janari i vitit të ardhshëm akciza e duhanit pritët të rritet. Kjo taksë do të pësojë një tjetër rritje nga 5750 lekë për 1000 copë që është sot, në 6000 lekë për 1000 copë. Ministria e Financave pret ditën e sotme propozimet e biznesit.



TATIMI MBI PAGAT

Tatimi për pagat mbi 130 mijë lekë në muaj aktualisht është 23%. Me paketën e re fiskale, qeveria propozon uljen e tatimit për këtë fashë pagash. Gjatë mbledhjes së sotme të Këshillit Konsultativ pritët që biznesi të propozojë uljen e tatimit mbi pagat e larta në 18 përqind.

me norma të ndryshme tati-more. Tatimi për pagat mbi 130 mijë lekë në muaj aktu-alisht është 23%. Me pa-ketën e re fiskale qeveria

propozon uljen e tatimit për këtë fashë pagash. **AKCIZA E DUHANIT** Por nga 1 janari i vitit të ardhshëm akciza e duhanit

pritët të rritet. Kjo taksë do të pësojë një tjetër rritje nga 5750 lekë për 1000 copë që është sot në 6000 lekë për 1000 copë. Ministria e financave pret ditën e sotme nga biz-nesi propozimet e tyre për t'i diskutuar ato më pas e për të marrë vendimet lidhur me paketën e re fiskale. Me paga mbi 130 mijë lekë ka rreth 12 mijë të punësuar, ndërsa biz-neset që ndajnë dividend janë një përqindje shumë e vogël nga rreth 100 mijë bi-znese që ka Shqipëria. Një vit më parë qeveria ka prezantuar një plan taksash ku parashikonte që të ulte divi-dentin në 6 përqind dhe ta-timin mbi pagën për fashën e fundit në 18 përqind.

TREGUESIT FISKALË Ministria e Financave ka publikuar treguesit fiskale

të 8 mujorit të vitit 2018 ku rezultojnë se të ardhurat janë 9 miliardë lekë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të ardhurat totale për 8 mujo-rin 2018, u realizuan në vlerën 294 miliardë lekë, me një rritje 3% ose 9 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe me realizim kund-rejt planit të periudhës në masën 99%. Të ardhurat e arkëtuara nga "tatimet dhe doganat" (përfshirë kontri-butet e mbledhura nga D.P.T) për 8 mujorin 2018, janë 259 miliardë lekë, 4.3% ose 10.7 miliardë lekë më shumë se 8 mujori i vitit 2017 dhe me realizim kund-rejt planit të periudhës në masën 99.6%. Të ardhurat nga "Taksa Doganore" janë realizuar në vlerën 4 miliardë lekë, me

realizim kund-rejt planit të periudhës në masën 96.2%. Të ardhurat nga "Akciza" janë realizuar në vlerën 29.7 miliardë lekë, me realizim kund-rejt planit në masën 98%. Ndikim ka pasur "Kar-buranti" (import-prodhim vendas), që rezultoi rreth 384,075 ton, me një rritje prej 2,897 ton ose +0.8% kraha-suar me 8 mujorin e vitit 2017. Gjithashtu, performancë pozitive si rezultat i rritjes së sasisë kanë shënuar: importi dhe prodhimi i "Birrës" +2.4%; importi i "Duhanit" +4.9%; importi i "Vaj lubrifikant" +6.3%, im-porti i "Kafes" +8.4%. Dekla-rimi i prodhimit vendas të duhanit është rritur nga 7 ton në 13 ton të deklaruar në periudhën Janar-Gusht 2017.

Prezantimi do të miratohet nga ERRU

Ndryshimi i çmimit të ujit, konsultime me banorët e zonës ku operon UK

Ndryshimi i tarifave të ujit të pijshëm nuk mund të bëhet pa u konsultuar më parë me publikun e zonës ku operon shoqëria e ujësjellës-kanalizimeve. Ndërkohë që, Enti Rregulator i Ujit ka miratuar rregulloren e re, mbi bazën e të cilës ujësjellësat janë të detyruar të organizojnë dëgjuesën publike. Operatorët duhet të organizojnë konsultimin para se të aplikojnë pranë Entit për ndryshim tarifash, por tashmë shoqëritë nuk kanë më të përcaktuar afatin kohor, i cili deri më tani ishte 30 ditë përpara aplikimit. Sa i takon prezantimit shoqëria duhet të përgatitë një prezantim që justifikon propozimin për nivelin e ri tarifor sipas modeleve të përcaktuara nga Enti, ndërkohë që ky prezantim duhet të marrë edhe miratimin e këtij të fundit para se t'i prezantohet publikut, një përcaktim që nuk ishte në rregulloren e mëparshme. Ndërkaq, përveç banorëve të njësive të qeverisjes vendore ku ofron shërbim operatori, sëra-nca dëgjimore është e hapur edhe për organizatat e mbrojtjes së konsumatorit



AFATI KOHOR

Operatorët duhet të organizojnë konsultimin para se të aplikojnë pranë Entit për ndryshim tarifash, por tashmë shoqëritë nuk kanë të përcaktuar afatin kohor, i cili deri më tani ishte 30 ditë përpara aplikimit.

apo të shoqërisë civile, medias, universitetit, strukturave komunitare, Komisioneve Këshillimore Qytetare, etj. Rregullorja përcakton se prezantimi i propozimit për tarifa të reja bëhet në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme për publikun, në veçanti përshkruhet gjendja e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, objektivat e Sho-

qërisë UK për vitet e ardhshme, si dhe nevoja për rritjen e tarifave të këtyre shërbimeve. Kjo pikë merr një rëndësi të veçantë, në një kohë kur nga eksperiencat të ngjashme sikurse janë dëgjesat publike që realizohen për hartimet e vlerësimit të ndikimit të mjedisit, akuzohen se janë tejet teknike dhe të pakuptueshme nga pjesëmarrësit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje makine shkatërrimi monedhash metalike për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqeruar me ftesa direkte kandidateve te huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 17,775,400 Lekë ose 93,300 Euro".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Haliu", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapakisht pagësen e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje makine shkatërrimi monedhash metalike për nevojat e Bankes së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 06 Nentor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Sipas të dhënave më të fundit nga Instituti i Statistikave, premtimi për shërbim shëndetësor e medikamente falas ka mbetur vetëm në letër. Shpenzimet për shëndetin kanë pësuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitet më parë. Të dhënat e INSTAT tregojnë se shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" kanë shënuar rritje prej 14,3 %, krahasuar me vitin 2016, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve për nëngrupin "medikamente". Rritje kjo e pajustificuar nëse do t'i referoheshim nismave ligjore të ndërmarra dhe premtimeve për shëndetësi falas.

Importohen mbi 22.7 miliardë lekë ilaçe

Shpenzimet për shëndetin, rritje me 14.3% krahasuar me 2016-ën

TE DHENAT

Të dhënat e INSTAT tregojnë se shpenzimet e bëra në grupin "Shëndet" kanë shënuar rritje prej 14,3 %, krahasuar me vitin 2016, rritje e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së shpenzimeve për nëngrupin "medikamente". Rritje kjo e pajustificuar nëse do t'u referoheshim nismave ligjore të ndërmarra dhe premtimeve për shëndetësi falas.

cila u reflektua në uljen e çmimit të tyre. Por me sa duket kjo ulje nuk është reflektuar në xhepin e familjeve shqiptare. Referuar të

dhëna zyrtare gjatë vitit 2017 janë importuar mbi 22.7 miliardë lekë medikamente. Nga kjo vlerë financiare e tregut të medikamenteve

gjysma janë blerë nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor i cili kishte një fond për rimbursimin në vlerën e 10 miliar-



dë lekëve. Por pavarësisht se gjysma e medikamenteve janë blerë nga fondet, që nënkupton se pacientëve do t'u jepen me rimbursim, përsëri shpenzimet që kanë bërë vetë pacientët kanë ardhur

në rritje. Kjo mund të jetë si rezultat i kritereve shtrënguese që ka miratuar vetë fondet për rimbursimin e medikamenteve të caktuara e kryesisht të barnave të shtrenjta.

Drafti/ Barriera të forta për të gjithë personat e varfër e të paarsimuar

Voltiza Duro

Germania ka lehtësuar procedurat e emigracionit nëpërmjet ligjit të ri që do të hapë dyert për të gjithë të interesuarit që duan të jetojnë e punojnë në një prej shteteve më të fuqishme ekonomikisht. Këtë të martë, partitë e koalicionit gjerman ranë dakord për një ligj të ri të emigracionit për të tërhequr punëtorë më të kualifikuar nga vendet jashtë Bashkimit Evropian. Kjo lëvizje nga ana e Gjermanisë ka si synim të mbushë vendet bosh të punëve dhe të stabilizojë sistemin publik të pensioneve.

DRAFTI

Një marrëveshje kompromisi që do të heqë barrierat në tregun e punës është arritur nga Kancelarja e qendrës së djathtë Angela Merkel, ministri i Brendshëm, Horst Seehofer dhe ministri i Punës i Social Demokratëve, Hubertus Heil. Ky kompromis do të vijë në ndihmë të gjithë qytetarëve nga vendet jashtë Bashkimit Evropian që kanë kualifikime profesionale dhe njohuri të gjuhës gjermane. Tre partitë e koalicionit ranë dakord për draftin këtë të martë. Si pasojë, kompanive do të lejohet të rekrutojnë punëtorë të huaj nga të gjitha profesionet, pavarësisht nga një listë zyrtare e sektorëve që kanë nevojë për punëtorë. Drafti gjithashtu propozon që qeveria nuk do të këmbëngulë që kompanitë t'u japin përparësi vetëm shtetasve gjermanë në vendet e lira të punëve, para se të kërkojnë të huajt jashtë BE-së.

Të diplomuarit

Gjithashtu, vlen të theksohet se ky draft synon që të diplomuarit e huaj dhe punëtorët me aftësi profesionale të kenë mundësi të shkojnë në Gjermani për gjashtë muaj për të kërkuar një pozicion, nëse plotësojnë kualifikime të caktuara të punës dhe kërkesa të gjuhës gjermane. Ata, gjithashtu,

Gjermania lehtëson procedurat, hap dyert për të diplomuarit

Mundësi edhe për emigrantët me aftësi profesionale



KUALIFIKIMET

Ky draft synon që të diplomuarit e huaj dhe punëtorët me aftësi profesionale të kenë mundësi të shkojnë në Gjermani për gjashtë muaj për të kërkuar një pozicion, nëse plotësojnë kualifikime të caktuara të punës dhe kërkesa të gjuhës gjermane.

duhet të dëshmojnë se kanë burime të mjaftueshme financiare për të përballuar jetesën, në mënyrë që ata të mos varen nga asistencë sociale gjatë qëndrimit të tyre në Gjermani. Marrëveshja e kompromisit nuk përfshin propozimin e ashtuquajtur "Spurwechsel", i cili do t'u lejonte refugjatëve që jetojnë në Gjermani të hiqnin dorë nga status i tyre i azilkërkuësve nëse gjejnë punë dhe mësojnë gjermanishten. Seehofer, partia e të cilit i frikësohet humbjes së

votesit të së djathtës ekstreme në zgjedhjet rajonale më vonë këtë muaj, ishte kundër një dispozite të tillë, pasi mendonte se do të inkurajonte emigracionin nga azilkërkuësit pa aftësi të duhura. "Ne ruajmë parimin e ndarjes së azilit dhe emigracionit të fuqisë punëtorë", thuhet në draftin e ligjit për emigracionin. Por, partitë cilësuan se do të përcaktin një status qëndrimi për refugjatët të mirë-integruar, të cilët nuk mund të dëbohen dhe se janë në

gjendje të përballojnë vetë jetesën, me qëllim që t'u japin punëdhënësve dhe emigrantëve më shumë siguri.

TË PAARSIMUARIT

Ndërkohë ky draft ngre barrierat të forta për të gjithë emigrantët e varfër e të paarsimuar që dëshirojnë të jetojnë në Gjermani. Ata tashmë do të kenë shumë më të vështirë të sigurojnë qëndrimin në këtë shtet. Kjo pasi ky draft qëndron për parimin të ndarjes së azilit nga emigracioni i krahut të punës, dhe siguron që të gjithë personat me të drejtë ligjore për të pretenduar azil sipas ligjit gjerman, do të jenë në gjendje ta bëjnë një gjë të tillë. "Shtetasit që nuk vijnë nga vendet e BE-së e që nuk kanë arsim të lartë apo një ofertë konkrete pune, nuk do të jetojnë dot në ekonominë më të fuqishme të Europës. Ne nuk duam emigracion nga shtetas të pakualifikuar të një vendi të tretë", theksohet në draft.

ARSIMIMI

"Shtetasit që nuk vijnë nga vendet e BE-së e që nuk kanë arsim të lartë apo një ofertë konkrete pune, nuk do të jetojnë dot në ekonominë më të fuqishme të Europës. Ne nuk duam emigracion nga shtetas të pakualifikuar të një vendi të tretë", theksohet në draft.

Ashtu si modeli kanadez, emigrantët që do të pranohen, do të renditen në bazë të nivelit të arsimit, aftësive të gjuhës, ofertave të punës dhe sigurisë financiare. Agjencia e lajmeve DPA citon ministrin e Punës Hubertus Heil të pohojë se kreu i Ministrisë së Brendshme Horst Seehofer ka rënë dakord se ekzekutivi duhet të kujdeset më shumë që të mos deportohen njerëzit e gabuar. "Punëtorët e kualifikuar kanë dhënë tashmë një kontribut të vyer në konkurrueshmërinë e ekonomisë gjermane", nënvizohet në dokument.



Teknologjia e Informacionit, 470 mësues për këtë lëndë

Mësuesit që japin lëndët e teknologjisë së informacionit dhe nxënësit e pasionuar pas teknologjisë do të kenë përveç librave të digjitalizuar nga kurrikula e re edhe një platformë online në shqip të dedikuar për ta. Teksa teknologjia përparon çdo ditë e më shumë, mësuesve u nevojiten trajnime për të marrë njohuritë për zhvillimet e fundit teknologjike e më pas për t'ia transmetuar nxënësve. Ndaj përgjatë këtij viti shkollor parashikohet të trajnohen 470 mësues që japin këtë lëndë, ndërkohë që nxënësit në këtë platformë kanë video tutoriale dhe mundësi interaktive të për çdo informacion që ju duhet. Ministria e Arsimit Lindita Nikolla duke theksuar se tregut i nevojiten njerëz të kualifikuar dhe me njohuri të shëndoshë në këto fusha nënvizoi se lëndët e integruara të teknologjisë falë kurrikulës së re janë bërë pjesë e shkollës që në klasën e katërt. Në këtë këndvështrim edhe kompetenca që lidhet me teknologjinë dhe informacionin ka bërë të mundur që të futet në pjesë të kurrikulës që në klasën e 4-ërt. Ndryshe nga më parë, që fillonte në klasën e mëvonshme të formimit në arsimin parauniversitar, pra fillonte në klasën e 7-të, me kurrikulën e re ajo fillon në klasën e katërt.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 3/438+2-53, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 36, FAQE 37, SIPERFAQE 103 M2, ZONA KADASTRALE 8380, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. ALBAN QEMAL BALA.

ÇMIMI 8.700.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 29.10.2018 .

CEL. 0684026666 ; 0693262866

Reagon mbrojtja e 5 të pandehurve: Pretenca, e diktuar politikisht

Banda "Shullazi", prokuroria kërkon 17 vite burg për Emilianon dhe 64 vite për të gjithë bandën

Gjyqi, policia "blindon" me autoblanda dhe snajperistë godinën e Gjykatës së Krimeve të Rënda

TIRANË

Prokuroria e Krimeve të Rënda, pas shtatë seancash gjyqësore dhe dje pretendën për Emilianon Shullazin dhe katër anëtarët e grupit të tij kriminal. Përfaqësuesit e akuzës kërkuar dënimin me 64 vite burg në total për të gjithë anëtarët e bandës. Pretenca është përgatitur nga prokurorët Donika Prela, Besnik Muçi, Anton Martini dhe Gent Osmani. Vetë drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda nuk ishte e pranishme në seancë, por është përfaqësuar nga tre prokurorët e tjerë. Konkretisht, u kërkuar dënimi me 17 vite burg për Shullazin, i cili sipas prokurorisë është drejtuesi i grupit; 15 vite burg për Gilmano Danin, 10 vite burg për Blerim Shullazin si dhe nga 11 vite burg për Endrit Qyqjan dhe Endrit Zelën. Pretenca e prokurorisë është dhënë në mungesë, pasi asnjë prej anëtarëve të bandës nuk ishte në pranishmë në seancën gjyqësore. Që prej orëve të para të mëngjesit, Gjykata e Krimeve të Rënda ishte e blinduar nga forca të shumta policie të vendosura në gjithë perimetrin e saj. Frika për një arratisje të mundshme të të pandehurve detyroi policinë të bëjë një plan të detajuar, duke përfshirë edhe forca rezervë, autoblanda si dhe snajperistë të vendosur mbi tarracën e ndërtesës. Në ambientet e gjykatës, përveç grupit të prokurorëve u lejuan të futen vetëm përfaqësues të ambasadës amerikane dhe asaj gjermane, që ndoqën nga afër pretendencën.

PRETENCA

Në materialin prej 66 faqesh, prokurorët kishin rënditur argumentet dhe provat mbi bazën e të cilave kërkuar edhe fajësinë e të akuzuarve. Sipas tyre, Shullazi dhe anëtarët e grupit të drejtuar prej tij, përmes shantazhit, kërcënimit fizik e psikologjik si dhe kanosjes me armë i kanë zhvatur Ylvi Beqjas shumën prej 500 mijë eurosh. "Paratë - thanë prokurorët - Ylvi Beqja ua ka dorëzuar 'cash' dhe përmes çeqeve bankare". Mendimi kriminal për t'i marrë paratë Beqjas - theksohej në dosje - i ka lindur Shullazit në momentin kur biznesmeni, që mban statusin e të penduarit të drejtësisë - i kërkoi ndihmë për të regjistruar në hipotekë ish-hotel "Vollgën". Për këtë shërbim, ai i kishte premtuar Shullazit 20% të aksioneve, por kur më vonë



Policia në Gjakovë e Krimeve të Rënda



e ka shitur pronën tek një biznesmen, i pandehuri i ka kërkuar që t'i jepte paratë dhe më shumë aksione nga pronat. Banda "Shullazi" akuzohet se ka kërcënuar për dhënie pasurie edhe biznesmenët Jani Zaka e Adriatik Kërçuku, por kur ka hasur rezistencën e tyre, ua ka shkatërruar pronat me eksploziv. Prokuroria theksoi se biznesmeni Zaka, i ndjerë i kërcënuar për jetën është larguar nga Shqipëria bashkë me familjen. Për kërcënimin e dy profesorëve Dhori Kule dhe Mynyr Koni, për ta detyruar këtë të fundit që të tërhiqej nga gara për rektor, prokuroria iu referuar dëshmitë të dhëna nga zyrtarë të lartë të shtetit dhe policisë shqiptare, përmes të cilave pretendon se provohet fajësia e Shullazit dhe grupit të tij.

REAGIMI I MBROJTJES

Kundër pretendencës dolën avokatët, të cilët e cilësuan atë një tregim të sajuar dhe plot gafa të bëra nga trupa e prokurorëve, të cilët i ironizuan se nuk njohin as të pandehurit. Më herët, avokatët akuzuan drejtuesen e re të



Emiliano Shullazi dhe anëtarët e grupit në gjykatë

| PRETENCA E PROKURORISË PËR BANDËN "SHULLAZI" | |
|--|--------------|
| 1.Emiljano Shullazi | 17 vite burg |
| 2.Gilmando Dani | 15 vite burg |
| 3.Blerim Shullazi | 10 vite burg |
| 4.Endrit Qyqja | 11 vite burg |
| 5.Endrit Zela | 11 vite burg |

prokurorisë, Donika Prela, të cilës me ironi i drejtohehin si "drejtoresha e ndërmarjes". Sipas tyre, në shkëlqje të ligjit, Prela është vetëaktruar si prokurorë e çështjes, e në mbështetje ka marrë edhe njerëzit e saj të besuar për të lexuar pretendencën e diktuar politikisht. Mbrojtësit

hodhën akuzë ndaj prokurorëve se kanë fshehur CD me përgjime, duke futur në dosje vetëm ato pjesë që iu interesojnë. Për këtë arsye, kërkuar riçeljen e shqyrtimit gjyqësor, por u rrëzuan nga gjykata. Pretendimet e tyre pritet të dëgohen në seancën e radhës, më datë 9 tetor.



Emiliano Shullazi dhe anëtarët e grupit në gjykatë

I dehur përplasi disa makina, lirohet shefi i policisë së Patosit

FIER - Gjykata e Fierit ka dhënë masën e sigurisë "Detyrim paraqitje" për shefin e Stacionit Policor në Patos, Flamur Velu. Efektivi 60-vjeçar u arrestua të dielën në aksin rrugor Fier-Lushnje në vendin e quajtur "Mulliri i artë", pasi në gjendje të dehur shkaktoi aksident, duke përplasar disa makina me automjetin e tij tip "Fiat Stilo". Pas ngjarjes, policia bëri me dije se arrestimi i Veluit ishte bërë nga SHÇBA dhe se në testin e alkoolit rezultoi se ai ishte i dehur.



Gardisti 30-vjeçar vret veten gjatë orarit të shërbimit

TIRANË - Një tjetër punonjës i Gardës së Republikës dyshohet se ka vrarë veten me armën e shërbimit. Bëhet fjalë për Ariol Mançen, me origjinë nga Përmeti, i cili sipas burimeve zyrtare i ka dhënë fund jetës së tij mbrëmjen e së hënës rreth orës 23:30 në ambientet e Gardës së Republikës. 30-vjeçari nga Përmeti po kryente shërbimin pranë hyrjes dytësore të institucionit, ndërsa mësohet se përpara se të ndërmerre aktin ekstrem, i ka dërguar një mesazh babait të tij, ku i kishte shkruar arsyen pse po e merrte këtë vepër. Gjithashtu, ai ka lënë një shënim në librin shërbimit ku shkruante se do t'i jepte fund jetës. "U ndava nga e dashura, ndaj po ndahem edhe nga kjo jetë", ishte mesazhi i të riut. Për hetimin e rasti u ngrit një grup i posaçëm nën drejtimin e prokurorisë. Hetimet po vijojnë për zbardhjen e të gjitha rrethimeve të ngjarjes. Ndërkohë, mësohet se Mançe kishte 3 vite që shërbente në Gardë, ndërsa ishte një ushtarak i kualifikuar. Po ashtu, mësohet se i riu kishte qenë pjesë e misioneve paqeruajtëse jashtë vendit, si në Irak. Ky është rasti i dytë brenda tre muajsh ku efektivi të Gardës vetë-vriten brenda institucionit. Më 30 qershor, në parkingun e Gardës vetëvra efektivi Shkëlzen Qordja, shofer i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

SHPLLJE ANKANDI
Date 08.10.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë, Tel. 404506426, Col. 067 201 9460/068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall anandën e tregit për pasurinë e paluajtshme të dobilit Luan Zef Palli dhe dorëzueses Loreta Pjeter Palli: "Aparatimi" me sipërfaqe 889 m², nr. pasurie 47162+1+12, zona kadastrale 8631, volumn 6, faqe 20, adresë Rr. "Gura", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë.
Nëmi fillistar i ankandit të tregit është në shumën 2 177 990 (dy milionë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) leke.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

NJOFTIM ANKANDI
Përmbaruesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lgji "Dema Stafa" Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Fierit i Gjyqësor Shkoder njofton se me datë 01.10.2018 ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i dyte për shitenj e pasurisë se paluajtshme e llojit Ndertese, Kati perbere nga dy dhoma,banjo,koridor,sallon dhe ballkon me sip.123 m², me nr.radhoni 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lgji "Naim Gjylbegu" Rr.Sali NivicaShkoder ne vleren 3.303.216 leke (Tremilion e treqind e tre mije e dyqind e gjashtembdhjetë leke)
Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesmarrjen ne ankand)
Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Përmbarueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emailit. ermira.mhilli@hotmail.com

NJOFTIM ANKANDI
Përmbaruesja Gjyqësore Ermira Mhilli me adresë Lgji "Dema Stafa" Rr. "Don Bosko", perballë Gjykatës së Fierit i Gjyqësor Shkoder njofton se me datë 01.10.2018 ora 16:00 në ambientet e saj do të zhvillohet ankandi i dyte për shitenj e pasurisë se paluajtshme e llojit Ndertese, Kati i para i perbere nga dy dhoma,banjo,koridor,sallon dhe ballkon me sip.123 m², me nr.radhoni 1587 date 23.11.1998 e ndodhur ne Z.K.8592.Lgji "Naim Gjylbegu" Rr.Sali NivicaShkoder ne vleren 3.395.040 leke (Tremilion e nenteqind e nentëdhjetë e pesemije e katerdhjetë leke)
Personat e interesuar duhet te derdhen fillimisht shumen prej 10% te vleres si garanci ne Banken Raiffeisen-Dega Shkoder (per pjesmarrjen ne ankand)
Ofertuesit te drejtohen prane Zyres se Përmbarueses Gjyqësore Ermira Mhilli, ose te kontaktojnë nepermjet Nr.tel 0692219253 ose adreses se emailit. ermira.mhilli@hotmail.com

50-vjeçarit i vihet nën sekuestro kompleksi "Pelikani"

I sekuestrohen 1 mln euro pasuri fierakut të dënuar me 32 vite burg në Itali për trafik droge

FIER - Policia e Fierit ka sekuestruar dje 1 milion euro pasuri të paluajtshme Vangjel Ziajt (Arben Gropa), pasi dyshohet se i ka vendosur përmes aktivitetit kriminal dhe konkretisht nga trafiku i drogës. Sekuestrimi është bërë në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". 50-vjeçari është personazh i njohur nga policia dhe aktualisht ndodhet në burg në shtetin italian për trafik droge. Ndërkaq, në Shqipëri ndaj tij ka një hetim të hapur për pastrim parash. "Në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave, gjurmimit, gjetjes, sekuestrimit me qëllim konfiskimi të

aseteve kriminale që rrjedhin nga veprimtaria kriminale, është hapur procedimi penal i regjistruar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal për hetime të pasurisë së shtetasit Vangjel Ziaj (Arben Gropa)", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Po të njëjtat burime bëjnë me dije se në përfundim të ve-

primeve të kryera, nga ana e sektorit për hetimin e krimit ekonomik e financiar në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier në bashkëpunim me prokurorinë, u zbatua vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për sekuestro preventive në lidhje me pasuritë e shtetasit Vangjel Ziaj, banues në Fier. Ky shtetas është dënuar nga autoritetet italiane me 32 vjet e 6 muaj burg për veprën penale "Trafiku i narkotikëve"

dhe është duke vuajtur dënimin në Itali. Pasuritë e sekuestruara që kapin vlerën e 1 milion euro janë: kompleks shërbimesh "Pelikani" i ndodhur në lagjen "Sheq i Madh" Fier; një apartament me sipërfaqe 70 metra katrorë në lagjen "Kryengritja e Fierit" si dhe një automjet i markës "Benz". Policia vijon punën për identifikimin e pasurive të tjera që mund të ketë ky shtetas dhe personat e lidhur me të.



Kompleksi "Pelikani"



50-vjeçari Vangjel Ziaj

50-vjeçari Vangjel Ziaj i njohur edhe si Arben Gropa u arrestua në janar të vitit 2014, pasi ishte dënuar nga drejtësia italiane për trafik droge me vlerë rreth 300 milionë lireta. Në pritje të ekstradimit, ai u la në arrest shtëpie nga autoritetet sh-

qiptare, por u arratis 7 muaj më pas. Ndërkohë që një rreth vit më pas u arrestua dhe u ekstradua në Itali për të vuajtur dënimin. Gropa është pronar i lokalit luksoz "Pelikani" në këtë qytet, si dhe aksioner në ndërtime.

Ngjarja në Allias, SHÇBA procedon Sidion Tabaku dhe efektivin

Nuk iu përgjigj urdhrët për të ndaluar, policia plagos me armë në këmbë mikun e Stresit

24-vjeçari: Qëlluan 4 herë drejt meje dhe më goditën me shqelma, kërkoj drejtësi

Dorjana Bezat

TIRANË

Një 24-vjeçar nga Tira na është plagosur me armë zjarri në këmbë, pasi nuk i është bindur urdhrët të policisë për të ndaluar. I riu Sidion Tabaku ka përfunduar në Spitalin e Traumës në kryeqytet ku dhe po merr ndihmë mjekësore. Ngjarja është regjistruar mbremjen e së hënës në zonën e Alliasit, në Tiranë. Ndërkaq, Tabaku deklaroi dje për "News 24" se ka qenë duke drejtuar një motor, por nuk i ishte bindur urdhrët të policisë dhe kjo e fundit është vënë në ndjekje të tij. I riu u shpreh se nuk e dinte që e ndiqte policia. "Policët qëlluan 4 herë me armë drejt meje. Pasi u rrezova kur më plagosën, më kanë dhunuar me shkelma. Më lanë në rrugë dhe u larguan", është shprehur i plagosuri. Ndërkohë, mësohet se Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) ka nisur një hetim për ngjarjen. Përmes një deklaratë për mediat, SHÇBA bëri me dije se 24-vjeçari është proceduar për mosbindje ndaj policisë dhe drejtim mjeti pa patentë. Po ashtu ka nisur procedimin edhe për efektivin e policisë me inicialet B.B., pasi akuzohet për plagosje nga pakujdesia. Sipas SHÇBA, arma e punonjësit të policisë ka realizuar qitje të pavullnetshme. Nga verifikimet e bëra, Tabaku rezultoi si person i dyshuar për një vjedhje disa vite më parë. Blutë pretendojnë se patrulla nuk ka qëlluar në drejtim të tij, por plumbi mund të ketë bërë rikoshet. Ngjarja në fjalë u denoncua më herët ditën e djeshme nga deputeti i PD-së, Ervin Salianji. Nga ana tjetër, Sidion Tabaku (mik i këngëtarit Stresi) kërkon drejtësi,



24-vjeçari i plagosur, Sidion Tabaku

pasi sipas tij, policia ka tentuar që ta vraste. **Çfarë ka ndodhur mbremjen e djeshme?** Rreth orës 23:10 apo 23:20 isha duke kaluar në drejtim të spitaleve dhe aty ishin dy patrulla policie. Vura re që po më vinin nga pas. Unë u tremba dhe i dhashë gaz motorit, por ata shtinë me armë. **Shtinë me armë drejt teje?** Po, shtinë drejt. Ndërkohë vazhdoj eci prapë dhe dëgjoj një krisim të dytë. Sa kaloj një karburant, futem në lagje. Më pas dëgjoj ty krisma të tjera. Një nga plumbat më kapë në këmbë. Më pas bie përtokë.

Ata më pas nisën të më gjuajn. **S'të ndihmoi policia?** Për ç'a do më ndihmonte policia?! **Kush të sollë në spital?** Ishte një oficer i rajonit nr.4 ai që lajmëroi ambulancën. Më pas më dërguan këtu në spital. **Punonjësi i policisë ishte rastësisht aty apo ishte pjesë e patrullës?** Jo, ishte rastësisht. Për fat më futi direkt në ambulancë dhe më çoi në Spitalin Usharak. **A i frikësoheshit ndonjë vepra penale që u larguan nga patrulla, apo...?**

Jo, isha shumë në rregull, me dokumente dhe të gjitha. **Po pse nuk i qëndruat patrullës atëherë?** Nuk ndalova se isha i frikësuar se thash çfarë ka ndodhur që vinin me kaq vrull. S'kisha asgjë, as drogë, asgjë tjetër. Isha shumë i pastër. **Çfarë dëmtimesh keni marrë?** Kam mpiksje gjaku në kokë, frakturë dhe një plumb që kam marrë në këmbë. **Çfarë të kanë thënë mjekët?** Më kanë thënë se do rrish tri ditë në spital dhe do bëjmë disa skanera dhe analiza për mpiksjen e gjakut. **Çfarë do të bëni në këtë situatë kur pretendoni se jeni dhunuar nga policia?** Unë dua që të vihet drejtësia në vend, asgjë tjetër. **Keni bërë kallëzim në SHÇBA?** Akoma. Po presim që të vinë eprrorët të marrin në pyetje. **Nuk keni dhënë asnjë deklarinë në polici?** Deri tani jo, pasi nuk ka ardhur askush. Pres që të vijë policia, të më marrë në pyetje. Së dimë se çfarë do bëhet më pas.

Plagosja e të riut, SHÇBA: Polici shkrepë armën në mënyrë të pavullnetshme

TIRANË - Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme dhe policisë së Sidion Tabaku. Në datë 1 tetor 2018, rreth orës 23:00, shtetasit S.T., duke lëvizur me një çiklomotor pa kaskë mbrojtëse në "Rrugën e Dibrës", iu bë shenjë nga një patrullë e policisë për të ndaluar. Ai nuk ka ndaluar, por ka shtuar shpejtësinë dhe është futur në një rrugicë përballë spitalit "Nënë Tereza". Për disa minuta ndjekjeje nuk u është përgjigjur urdhrave të patrullës së policisë. Gjatë lëvizjes nëpër rrugicë, i riu është rrezuar nga motori dhe ka vijuar lëvizjen me vrap. Punonjësi i policisë më afër tij, në ndjekje e sipër ka dyshuar se shtetasi S.T. ka pasur në dorë një send të dyshimtë si armë zjarri. Kështu, efektivi ka nxjerrë armën e shërbimit për ta mbushur; për çdo eventualitet a rrezik, pasi ndjekja po vijonte në gjysmë errësirë në rrugicë. Në këto kushte arma e punonjësit të policisë ka realizuar qitje të pavullnetshme. Pas kësaj, punonjësit e policisë kanë vuajtur ndjekjen për rreth 100 metra dhe arritën ta kapin 24-vjeçarin. Patrulla kur e konstatoi gjendjen e tij, i ka dhënë ndihmën e parë dhe e shoqëroi S.T. për ndihmë në spital me ambulancë, pasi kishte dëmtime në fytyrë, shkakuar nga rrezimi me motor dhe në pjesën e pulpës së këmbës. Në fund të veprimeve hetimore, shtetasi S.T. është proceduar në gjendje të lirë për "Mosbindje ndaj urdhrave të punonjësit të rendit publik" dhe "Drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt". Hetimi është kryer nga strukturat e SHÇBA Tiranë, të cilat kanë proceduar punonjësin e policisë B.B., për "Plagosje nga pakujdesia".



Permbuesi Gjyqësor Privat Çezar Beja
 Fq 78, Sip 2950m2, Adresa Rade, Njësia Administrative Manez, Bashkia Durrës
 Çmimi ankandit të trette është 2.509.166 leke
 2.Lloji i pronës: "ARE", Nr Pas 38/33, ZK 3137, Vol 5, Fq 82, Sip 2590m2, Adresa Rade, Njësia Administrative Manez, Bashkia Durrës
 Çmimi ankandit të trette është 4.273.236 leke
 Ankandi do të zhvillohet në zyrën e përmbuesit gjyqësor privat Çezar Beja në datën 10.10.2018 duke u mbyllur në orën 16:00

Në kuadër të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhomë Kombëtare e Neterise (DH.K.N.) nga Operatorët Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.
 Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pageses prej **10.000 leke**, pranë Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri.
 Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

Qendra e Shërbimeve Arsimore: Dokumentacioni që ju duhet ditën e provimit

Voltiza Duro

Shpallen emrat e 867 mësuesve që do t'i nënshtrohen provimit në tetor

Kush do të testohet në Histori-Gjeografi, Arsim Fillor e Frëngjisht

Ka filluar testimi për mësuesit kandidatë që dëshirojnë të fillojnë punën në një nga institucionet e arsimit parauniversitar në vend. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listat me emrat e 867 mësuesve që do të kryejnë testimin e informatizuar në periudhën 4-15 tetor, sipas kalendarit. Të gjithë të interesuarit mund të verifikojnë ditën e provimit sipas profileve Gjuhë Frënge, Arsim Fillor, Biologji; Biologji-Kimi; Histori-Gjeografi; Edukim Fizik, Kimi, etj. Testimi i informatizuar do të zhvillohet në mesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore në Tiranë ku kandidati duhet të para-

qitet 30 minuta para fillimit të testimit. Ai duhet të jetë i pajisur me letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë); kopje të Kartë ID ose Pasaportë; si dhe duhet të ketë formularin e pranimit nga ana e DAR/ZA për fazën e dytë të

konkurrimit. Të gjithë ata kandidatë, të cilëve u mundgohjnë këto dokumente, nuk mund të marrin pjesë në testimin e informatizuar. "Tarifa e depozituar për llogarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit. Kandidatët lutemi të paraqiten VETËM

në orarin e përcaktuar. Në rast pasaktësie në të dhënat e paraqitura në web, lutemi të kontaktoni në adresën provimeshteti@outlook.com si dhe të njoftoni përpara se të hyni në ambientin e provimit", -theksohet në

njoftimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Ndërkohë kandidatët që regjistrohen për provimin e shtetit, duhet të jenë të pajisur me diplomatë e cillit të parë dhe të dytë të studimit, të lëshuar nga IAL-të përkatëse.

EMRAT E MËSUESVE QË DO T'I NËNSHTROHEN PROVIMIT NË TETOR

Table with 4 columns: ID, Emri, Mbiemri, Data e provimit. It lists 867 candidates for the September exam, including names like Bajmonda, Rajmonda, Besim, etc., and their respective exam dates.

"Blair negociator", kreu serb: Bisedimet me Kosovën i drejtoj unë

Vuçiç raporton te Putin: Me Kosovën s'kemi zgjidhje

Marrëveshja me Serbinë, ç'priet nga asociacioni

Presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiç, ka zhvilluar sot një takim me Presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, ku ka diskutuar edhe për dialogun me Kosovën. Vuçiç ka shprehur te Putini shqetësimin e tij se Serbia është shumë larg gjetjes së një zgjidhjeje me Kosovën, siç shkruan "Tanjug". "Pavarësisht përpjekjeve të Serbisë për zgjidhje të qëndrueshme, jemi shumë larg gjetjes së një zgjidhjeje për Kosovën", tha Vuçiç nga Moskë. Ndërkohë, ai foli edhe për provokimet e Kosovës me të cilat sipas tij përballat Serbia. Ndërkaq, presidenti serb Aleksandar Vuçiç, nga ana tjetër ka hedhur poshtë zërat se negociatat me Kosovën po udhëhiqen nga ish-kryeministri britanik, Tony Blair. Ai nënvizoi faktin se kryenegociatori i Serbisë për çështje që lidhen me Kosovën është vetë ai. "Blair nuk negocion për asgjë, por negocioj unë dhe është vendimi i të dyja palëve, i pushtetit ekzekutiv. Emri im nuk është as Tony, as ndonjë tjetër, por Aleksandar", tha Vuçiç për televizionin "Pink". Në media u përfol se Blair ka biseduar me kancelaren gjermane Angela Merkel dhe me zyrtarë francezë për dialogun Serbi-Kosovë, ndërsa javën e ardhshme do të ketë një takim edhe me përfaqësues të Këshillit për Siguri Kombëtare të SHBA-ve. Ndërkohë, kreu i Partisë Popullore në Serbi, Vuk Jeremiç pohoi se Blair po dialogon në emër të Vuçiç. Ndërkaq, qeveria e Kosovës është e gatshme që të punojë në përsheptimin e procesit për formimin e asociacionit apo bashkësisë së komunave me shumicë serbe, por ajo ende nuk ka marrë ndonjë draft-statut të propozuar nga ekipi menaxhues, i cili është përgjegjës për hartimin e këtij draft-statuti - thonë zyrtarët e ekzekutiv-it të vendit. Një propozim për draft-statutin për asociacionin tashmë i është dorëzuar Bashkimit Evropian nga ekipi menaxhues, i cili përbëhet vetëm nga katër përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës. Halil Matoshi, këshilltar politik i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, thotë për Radion Evropë e Lirë, që qeveria e Kosovës nuk ka marrë ndonjë propozim për draft-statutin e asociacionit. "Pala serbe ka dërguar vetëm raportin e punës së komisionit, që ka qenë i caktuar nga qeveria paraprake se si e shohin ata e fillimin e asociacionit, por draft final ende nuk ka", tha Matoshi. Njëhësi serb i zhvillimeve politike, Petar Miletić, duke folur për Radion Evropë e Lirë, shpreh mendimin që reduktimi i çështjes së formimit të asociacionit në çështjen e statutit të tij është drejtim i gabuar. Por, ai ka theksuar se vetë au-



Aleksander Vuçiç në takim me Vladimir Putin në Moskë

RAPORTIMI NGA MOSKË
"Pavarësisht përpjekjeve të Serbisë për zgjidhje të qëndrueshme, jemi shumë larg gjetjes së një zgjidhjeje për Kosovën", tha Vuçiç nga Moskë në takimin e zhvilluar dje me kreun rus, Vladimir Putin, ku ndër të tjera u ankua edhe për "sulmin" nga presidenti kosovar, Hashim Thaçi.

ALEKSANDAR VUÇIÇ

"Blair nuk negocion për asgjë, negocioj unë dhe është vendimi i të dyja palëve, i pushtetit ekzekutiv dhe i qeverisë së Serbisë ta pranojnë atë si barrë dhe obligim. Emri im nuk është as Tony, as ndonjë tjetër, por Aleksandar", tha Vuçiç për televizionin "Pink".

ASOCIACIONI KOSOVË-SERBI

Një propozim për draft-statutin për asociacionin tashmë i është dorëzuar Bashkimit Evropian nga ekipi menaxhues, i cili përbëhet vetëm nga katër përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës.

Sheshel: 1000 ushtarë serbë të jenë të gatshëm për të hyrë në Kosovë

Kryetari i Partisë Radikale serbe (SRS) Vojislav Sheshel deklaroi se Serbia duhet të ketë 1000 ushtarë të gatshëm që të ndërhyjnë me krizën e parë në Kosovë. Gjatë fjalës së tij në Kuvendin e Serbisë, Sheshel shtoi se nuk ka kuptim që shqiptarët provokojnë gjithmonë krizë. "Nëse duhet të bëhen përforcime, të bëhen. Nëse keni nevojë për një forcë ajrore, hyjnë forcat ajrore", tha ai ndërsa shtoi se Rusia ka garantuar që mos ta lërë Serbinë në baltë.



VOJISLAV SHESHEL

"Nëse duhet të bëhen përforcime, të hyjnë. Nëse keni nevojë për një forcë ajrore, hyjnë forcat ajrore", tha ai, ndërsa shtoi se Rusia ka garantuar që mos ta lërë Serbinë në baltë.

Mal i Zi, 30 mijë nënshkrime për tërheqjen e njohjes së Kosovës

Kryetari i Këshillit Kombëtar serb në Malin e Zi, Momcilo Vuksanoviç ka thënë se deri më tani janë mbledhur rreth 30.000 nënshkrime në iniciativën e mbështetjes së referendimit shtetëror për tërheqjen e vendimit të Malit të Zi për njohjen e shtetit të Kosovës. "Shpresojmë se së shpejti do ta arrijmë cakun që kemi caktuar", deklaroi Vuksanoviç. Ai u paraqiti para mediave në Podgoricë, ku u zhvillua një mbledhje me iniciativë të Këshillit Kombëtar serb në Malin e Zi dhe ku u diskutua edhe për temën tjetër në interes të serbëve nga Mali i Zi.



MOMCILO VUKSANOVIÇ

"Shpresojmë se së shpejti do ta arrijmë cakun që kemi caktuar", deklaroi Vuksanoviç. Ai u paraqiti para mediave në Podgoricë, ku u zhvillua një mbledhje me iniciativë të Këshillit Kombëtar serb në Malin e Zi.

toritetet e Beogradit kanë ndikuar në zvarritjen e procesit të formimit të asociacionit, duke shpresuar që këtë çështje ta zgjidhin në kuadër të marrëveshjes finale për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Për sa i

përket asociacionit të komunave me shumicë serbe, duket që pala serbe në koordinim me politikat e Beogradit zyrtar po provon prolongimin që ta ndërlikojë një marrëveshje finale, çfarëdo që të jetë ajo, duke shpresuar se do të përfitojë

më shumë. Mirëpo, qëndrimi i vendosur i kryeministrit të Kosovës, Haradinaj është që asociacioni do të bëhet dhe sa i përket anës së qeverisë, statuti mund të shkruhet që sot, por do të jetë ekskluzivisht në suaza të Kushtetutës dhe ligjeve të

Kosovës. Në këtë pikë nuk do të ketë asnjë lëvizje militare", u shpreh Matoshi. Zyrtarët në institucionet e Kosovës patën theksuar se Kosova nuk e ka ndërmend ta ndryshojë Kushtetutën për t'i futur kompetencat e asociacionit brenda saj.

SHKURT

Përshihet në flakë anija me 335 pasagjerë në Detin Baltik

Një zjarr i madh ka shpërthyer në një anije pasagjerësh me 335 njerëz në bord në Detin Baltik, përfshirë edhe 37 anëtarë të ekvipazhit. Lajmi konfirmohet nga ushtria e Lituaniës. Zyrtarët lituanëzë kanë deklaruar se kanë dërguar një helikopter në anije dhe dy të tjerë janë në gatishmëri në rast nevojë. Anija në të cilën ka rënë zjarr ndodhet 135 km larg nga Kaliningradi. Sipas "RIA Novosti", ka informacione se një shpërthim ndodhi në dhomën e motorit të anijes. Ndërkohë, ende nuk dihen shkaqet e ngjarjes, por grupet hetimore po punojnë intensivisht për të përcaktuar të gjithë dinamikën.

Cunami në Indonezi, pamjet satelitore tregojnë katastrofën

Pamjet shokuese satelitore tregojnë se si tërmeti dhe cunami në Indonezi shkatërruan fshatra të tërë, ndërkohë që numri i të vdekurve ka arritur në 1200. Tërmeti me magnitudë 7.5 ballë tronditi të premtën vendin, duke shkaktuar një cunami me dallgë që kapnin 6 metra lartësi. Imazhet satelitore tregojnë shtëpi të shkatërruara e fshatra të zhdukur.

Juncker: Nuk duam në Itali një krizë si ajo e Greqisë

Pasi kemi kapërcyer krizën greke, nuk do të donim të njëjtën krizë në Itali, një krizë si ajo e Greqisë është e mjaftueshme", tha presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, gjatë një vizite në Gjermani. "Nëse Italia dëshiron një trajtim të posaçëm shtesë, kjo do të nënkuptojë fundin e euros. Duhet të jemi shumë të rreptë", - theksoi Juncker. "Italia po largohet nga objektivat buxhetore që kemi miratuar së bashku në nivel evropian", - shtoi ai.

SHBA-të do të shqyrtojnë shkatërrimin e një sistemi raketor rus

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në NATO, Kay Bailey Hutchison, ka thënë se nëse është e nevojshme, SHBA-të do të shqyrtojnë shkatërrimin e një sistemi raketor të Rusisë, që Uashingtoni beson se Moskë po e zhvillon duke shkelur një traktat të armëve bërthamore. Duke folur për gazetaret në Bruksel, ambasadorja Kay Bailey Hutchison i bëri thirrje Rusisë që të ndalë zhvillimin e sistemit 9M729, i cili sipas SHBA-ve, shkel Traktatin e Forcave Bërthamore me rreze të mesme, të vitit 1987. Rusia në anën tjetër ka mohuar ndonjë shkelje të traktatit, i cili ndalon raketat me rreze nga 500 deri në 5,500 kilometra.

Procesi mbyllës i Lotarisë Amerikane është përcaktuar data 6 nëntor në orën 18:00

Sot nis Lotaria Amerikane, gabimet që nuk duhet të bëni gjatë aplikimit

Duhet të keni shkollën e mesme apo ekuivalentin

Ditën e mërkurë në orën 18:00 Lotaria Amerikane do të nisë aplikimet, ndërsa në dispozicion deri në afatin përfundimtar janë 33 ditë. Procesi mbyllës i Lotarisë Amerikane është përcaktuar data 6 nëntor në orën 18:00.

Ambasada sqaron se të gjithë ata që duan të aplikojnë për Lotarinë Amerikane duhet të jenë shumë të kujdesshëm në plotësimin e formularit me të gjitha të dhënat që kërkohen.

KUSHTET E APLIKIMIT:

I lindur në një nga vendet kualifikuese: Në shumicën e rasteve kjo kupton vendin (shtetin) në të cilin aplikanti ka lindur. Gjithsesi, ka edhe dy mënyra të tjera, me të cilat një person mund të kualifikohet. E para, në qoftë se një person ka lindur në një vend ku vendasit e këtij vendi janë të pajzgjedhshëm për të aplikuar, por bashkëshorti(ja) e tij/i saj ka lindur në një vend ku vendasit janë të zgjedhshëm për të aplikuar, ky person mund të pretendojë vendin e lindjes së bashkëshortit(es) dhe në këtë mënyrë të dyve do t'u lëshohet viza që të hyjnë në SHBA njëkohësisht. E dyta, në qoftë se një person ka lindur në një vend ku vendasit e këtij vendi janë të pajzgjedhshëm, por as njëri as tjetri nga prindërit e tij/saj kanë lindur ose banuar atje në kohën kur persona ka lindur, një person i tillë mund të pretendojë vendndijndjen në një nga vendndijndjet e prindërve të tij/saj, në qoftë se ky vend është i kualifikueshëm për programin e DV-2020.

Për t'u regjistruar në lotari, ju duhet të plotësoni kërkesat e edukimit OSE të eksperiencës së punës të programit të lotarisë. Edukim ose punë e kualifikueshme:

Ju duhet të keni një arsim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë zyrtar 9-vjeçar dhe i mesëm; (pra të vërtetoni me bindje që keni mbaruar 12-vjet shkollë të plotë)ose të keni 2 vjet përvojë pune brenda 5 viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar. Për të përcaktuar nëse përvoja e punës kualifikohet për lotarinë, do të përdoret baza e të dhënave të Departamentit Amerikan të Punës O'Net Online. Në qoftë se ju nuk mund të plotësoni të dyja kërkesat e mësipërme, nuk duhet të aplikoni në programin e lotarisë.

INFORMACIONI I KËRKUAR PËR REGJISTRIMIN ELEK-



TRONIK EMRI I PLOTË: mbiemrin, emrin, emrin e mesit - ekzaktësisht, siç shkruhet në pasaportë. Tek emri i mesit do të klikoni kutinë: 'no middle name'.

DATA E LINDJES - ditë, muaj, vit.

GJINIA - Mashkull ose femër.

QYTETI I LINDJES SHETETI I LINDJES - Përdorni emrin me të cilin njihet aktualisht shteti ku keni lindur.

SHETETI I PRANUESHËM OSE I KUALIFIKUESHËM PËR PROGRAMIN E LOTARISË DV-2020 - Nëse keni lindur në Shqipëri, nuk ka nevojë t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Vendi i kualifikueshëm për programin e lotarisë normalisht do të jetë i njëjtë me atë të lindjes. Vendi i kualifikueshëm për programin e lotarisë nuk lidhet me ven-

din ku jetoni.

FOTOGRAFIA E REGJISTRIMIT - Sigurohuni që të përfshini - Fotografi personale pa syze, të nxjerrë 6 muajt e fundit, për ju si aplikant kryesor, të bashkëshortit/es dhe secilit prej fëmijëve të përfshirë në regjistrim. Shikoni "Fotografia Dixhitale" për specifikime teknike dhe të kompozimit. Nuk është e nevojshme të përfshini një foto të bashkëshortes/it dhe fëmijëve tashmë qytetarë amerikanë ose rezidentë të përhershëm të ligjshëm (me Green Card), por në rast se i përfshini, nuk do të ketë pasojë në aplikimin tuaj për vizë shumëlojshëmë.

Fotografitë në grup nuk do të pranohen, duhet të paraqisni nga një fotografi për çdo individ. Regjistrimi juaj mund të skualifikohet ose viza juaj të refuzohet nëse fotografitë tuaja nuk

janë të kohëve të fundit, janë të manipuluar në një formë apo në tjetrën, ose nuk respektojnë specifikimet e mëposhtme. Nëse përfshini fotografi që e kishit përdorur në regjistrimin e vitit të kaluar (DV-2019), ju do të skualifikoheni automatikisht, ndaj përdorni fotografi të nxjerrë kohët e fundit.

ADRESA E POSTËS - (Në emër të..., adresa rrethi 1, adresa rrethi 2, qyteti, rrethi, kod postar, shteti).

SHETETI - Ku jetoni aktualisht.

NUMRI I TELEFONIT - Jo i detyruar.

ADRESA E POSTËS ELEKTRONIKE (EMAIL) - Shkruani një adresë të postës elektronike (e-mail) në të cilën ju keni akses të plotë dhe direkt. Ju nuk do të merrni një mesazh zyrtar përzgjedhjeje në këtë adresë. Gjithsesi, nëse aplikimi/hyrja juaj përzgjedhet dhe ju i përgjigjeni njoftimit të përzgjedhjes tuaj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarit, ju do të merrni 'e-mail' e të tjera komunikuese nga Departamenti i Shtetit 'Qendra Konsullore në Kentucky (QKK)', duke ju njoftuar që informacioni me detaje i intervistës për vizën emigruese është vendosur në Kontrollin e Statusit të Regjistruarit. Departamenti i Shtetit kurrë nuk do t'ju dërgojë një 'e-mail' duke ju thënë se ju jeni përzgjedhur për programin e DV-së.

CILI ËSHTË NIVELI I LARTË I EDUKIMIT QË KENI ARRITUR, DERI NË

REGJISTRIMI

Ju duhet të keni një arsim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë zyrtar 9-vjeçar dhe i mesëm; (pra të vërtetoni me bindje që keni mbaruar 12 vjet shkollë të plotë)ose të keni 2 vjet përvojë pune brenda 5 viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar.

t'i lëshohet një vizë DV. Ndaj, nëse ju zgjidhni opsionin "i martuar" dhe bashkëshorti/ja ime është qytetarë amerikane, ose me (Green Card) tek aplikimi juaj, sistemi nuk do ju kërkojë të vendosni informacionin për bashkëshortin/in.

NUMRI I FËMIJËVE - Regjistrimet duhet të përfshijnë emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç në momentin e regjistrimit elektronik, pavarësisht nëse jetojnë apo jo me ju, apo s'kanë ndërmend t'ju shoqërojnë ose ndjekin për t'u bashkuar me ju të emigroni në Shtetet e Bashkuara. Sigurohuni që të përfshini të gjithë fëmijët biologjikë, si dhe të gjithë fëmijët ligjërish të bërësuar nga ju dhe të gjithë fëmijët/thjeshtërit nga martesat e mëparshme që janë të pamartuar dhe nën moshën 21 vjeç në datën e aplikimit tuaj elektronik, madje edhe në qoftë se ju nuk jeni më të martuar ligjërish me prindin e fëmijës dhe madje, edhe në qoftë se fëmija aktualisht nuk banon me ju dhe/ose nuk do të emigrojë me ju. Vine re se fëmijët e martuar dhe fëmijët mbi moshën 21 vjeç nuk mund të përfshihen, sepse nuk kualifikohen për programin e Lotarisë Amerikane DV-2020. Në qoftë se nuk i përfshini të gjithë fëmijët që janë të pranueshëm, do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe refuzimin e vizës për të gjithë pjesëtarët e familjes që aplikojnë në kohën e intervistës për vizë.

INFORMACIONI MBI BASHKËSHORTIN (ENI) - Emri, data e lindjes, gjinia, qyteti i lindjes, vendi/shteti i lindjes, fotografia. Në qoftë se nuk përfshini bashkëshortin(en), do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit principal dhe refuzimin e vizës për të gjithë pjesëtarët e familjes që aplikojnë në kohën e intervistës për vizë.

INFORMACIONI MBI FËMIJËT - Emri, data e lindjes, gjinia, qyteti i lindjes, vendi/shteti i lindjes, fotografia. Përfshini të gjithë fëmijët e deklaruar në pikën 14 sipër.



Ekskluzive/ Zbulohet letra sekrete e instruktorit të Komitetit Qendror, K. S. e janarit 1982, ku ai denoncon Kadri Hazbiun e Feçor Shehun, kur ata ishin ende në postin e ministrit

Nga Dashnor Kaloçi

Denoncimi: Kunati i Feçor Shehut fliste me diplomatën grek, Papas në spitalin e Vjenës

Raporti sekret: Shokut Kadri i kam thënë se s'më pëlqen afiniteti i shokut Feçor me M.T., ndaj të cilit Partia ka marrë masat si njeri imoral

Vetëm pak javë pas ngjarjes së 18 dhjetorit të largët vitit 1981, kur kryeministri Mehmet Shehu u gjet i vdekur në dhomën e tij të gjumit nga plumb-a pistolette në rrethana tepër misterioze për të cilat dhe sot pas 37 vjetësh vazhdohet të diskutohet ende, me porosi të Komitetit Qendror të PPSH-së, në të gjitha organizatat bazë të Partisë në mbarë vendin, u mbajtën dhe u zhvilluan mbledhje të shumta, ku diskutoheshin: "nën frymën e fjalës së shokut Enver Hoxha, për armikun Mehmet Shehu", të cilat do t'i shërbenin më pas Enverit për të shkruar "Tablonë Sinoptike për poliagjentin Mehmet Shehu"? Në të gjitha këto mbledhje, veç të tjerash, ashtu siç bëhet e ditur edhe nga një mori dokumentesh me siglën "Tepër sekret", që gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit, Arkivin e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pjesëmarrës e diskutantë të shumtë që kanë marrë fjalën aty, kanë hedhur lloj-lloj akuzash, me të vërteta dhe të pavërteta, denoncime, spiunime, shpifje, trillime, thashetheme, intriga, sajesa e gjithfarë u kanë ardhur për shtat, të gjitha këto në drejtim dhe kundër ish-kryeministrit të vdekur, Mehmet Shehu, familjes së tij dhe atyre që u konsideruan bashkëpunëtorë të tyre, duke përmendur me dhjetëra emra, si: ushtarakë, qeveritarë, funksionarë të lartë partiakë, etj. etj.. Po kështu, këto mbledhje u intensifikuan së tepërmi, sidomos pas tetorit të vitit 1982, kur u arrestua dhe ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu, (i cili për gati tri dekada me radhë kishte mbajtur postin delikat të ministrit të Brendshëm), ministri i Punëve të Brendshme, Feçor Shehu, ministri i Shëndetësisë, Llambi Zëçishti, zv/ministri i Punëve të Brendshme për Sigurimin e Shtetit, Mihallaq Zëçishti, etj., ku dhe ndaj tyre, u përsërit e njëjta tablo, si me ish-kryeministrin Mehmet Shehu. Dhe pas zhvillimit të këtyre mbledhjeve, komitetet e partisë të rretheve përkatëse, kanë hartuar një sërë raportesh me përmbledhje nga "problemet më kryesore", të cilat më pas ia kanë dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së. Për të gjitha këto mbledhje, gazeta "Gazeta Shqiptare" disponon një numër të madh dokumentesh të nxjerra nga një dosje voluminoze me siglën "Tepër sekret", ku ish-anëtarë të Byrosë Politike, sekretarë të



Komitetit Qendror të asaj kohe, si Spiro Koleka, Enver Halili, Vangjel Çerrava etj., etj., informojnë Komitetin Qendror për mbledhjet ku kanë marrë pjesë, duke dhënë me detaje dhe hollësiira gjithçka është thënë dhe diskutuar aty. Po kështu përveç këtyre raporteve, në dosjen në fjalë, gjenden edhe një sërë raportesh të hartuara nga funksionarë të rangjeve më të ulta që nga Komiteti Qendror e më poshtë, apo dhe raporte kolegjiale të Degëve të Punëve të Brendshme në rrethe, shtabeve, komandave dhe komiteteve të partisë së Korpusëve ushtarake, që ishin

edhe njësitë më të mëdha që kishte Ushtria shqiptare asokohe. Nga kjo dosje voluminoze që gazeta "Gazeta Shqiptare" e disponon të plotë, në disa numra të kaluar kemi publikuar raport-informacionin e ish-anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, Spiro Koleka, dërguar Komitetit Qendror, lidhur me aktivin e partisë të rrethit të Pogradecit, ku ai ka marrë pjesë si i deleguar, më 25 shtator të vitit 1982. Për të vazhduar në vijim, (në tre shkrime radhazi) me raport-informacionin "Tepër sekret" të sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Korçës, Enver Halili, dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së (personalisht Enver Hoxhës)

lidhur me punën dhe vepërimtarinë e Sigurimit të Shtetit në rrethin e Korçës si dhe "implikimin" e Mehmet Shehut, Kadri Hazbiut, Feçor Sheut etj, me punonjësit të Sigurimit dhe persona të tjerë në atë rreth dhe më gjerë. Por siç do të shohim edhe në dokumentin arkivor që po publikojmë në shkrimin e mëposhtëm, akuzat dhe denoncimet ndaj Kadri Hazbiut e Feçor Shehut nuk janë bërë vetëm pas arrestimit të tyre në vitin 1982, por ndaj tyre ka pasur informacione, akuzat dhe denoncime edhe vite më parë, gjatë kohës që ata ishin ende në detyrë në postet ministrore. Gjë e cila vërtetohet më së



miri edhe nga dokumenti në fjalë, ku rezultojnë se Enver Hoxha me anë sekretarëve të organizatave bazë dhe komiteteve të partive që ekzistojnë në çdo dikastër, si dhe rrjetit të madh të instruktorëve të partisë që vareshin prej tyre, "në rrugë partie", merrte rregullisht raporte, letra dhe informacione të detajuara prej tyre. Pra, në një farë mënyre, me anë të këtij "mekanizmi" Enver Hoxha dublonte Sigurimin e Shtetit, i cili, gjithashtu, ishte nën kontrollin e rreptë të Partisë dhe çdo informacion, raport, relacion, letra të ndryshme, etj., ishte i detyruar që t'ia niste "në rrugë partie" udhëheqjes së lartë në Komitetin Qendror të PPSH-së. Një nga këto raport-informacione sekrete, "në rrugë partie", është dhe ky që po publikojmë në këtë shkrim dhe që mban datën 5 janar 1982, pra vetëm dy javë pas ngjarjes së ndodhur me kryem-

instristrin Mehmet Shehu, ku instruktori i Komitetit Qendror, të PPSH-së, K.Z. që mbulonte Sigurimin e Shtetit, ka informuar eprorët e tij, lidhur me një "informacion" të cilën ia ka servitur para pak ditësh, një pensionist, I.N. ish-kuadër i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Informacioni, i cili bën fjalë rreth një ngjarje të largët të vitit 1973, kur ai shërbente në ambasadën shqiptare në Vjenë dhe që sipas tij, "implikonte" kunetërit e Feçor Shehut që asokohe mbanin funksione të larta në Sigurimin e Shtetit, në Ushtri etj., etj., ishte i detyruar që t'ia niste "në rrugë partie" udhëheqjes së lartë në Komitetin Qendror të PPSH-së. Një nga këto raport-informacione sekrete, "në rrugë partie", është dhe ky që po publikojmë në këtë shkrim dhe që mban datën 5 janar 1982, pra vetëm dy javë pas ngjarjes së ndodhur me kryem-





Spitali i pergjithshëm në Vjenë

fjalë, të cilin po e publikojmë të plotë, por


LETRA E INSTRUKTORIT TE KOMITETIT QENDOR QE MBULONTE SIGURIMIN

siste që të kujdesesha gjatë kohës që Petriti do të qëndronte për kurim. Unë, konform rregullave, e porosita

INFORMACION

Para disa ditësh shoku I.N. ish kuadër (oficer) në Ministrinë e Punëve të Brendshme, tani në pension, kërkoi një takim dhe erdhni në aparatet e Komitetit Qëndror të Partisë e më informoi mbi sa vijon:

"Në vitin 1973, kur unë isha me punë në ambasaden tonë në Vienë, erdhni për mjekime i quajtur Petrit Çobani, që me sa di unë, është kunati i shokut Feçorr Shehu. Më kishte sjellë një rekomandim nga i vëllai i tij, Hamdi Çobani, që atëherë ishte kryetar i degës së Sigurimit të Ushtrisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili më porosi



Petrit Çobani që të mos futej në biseda me të huajt, aq më tepër që ishte vetëm në spital. Në atë kohë erdhni nga Greqia një i quajtur Ilija Paspas, i cili ka qenë diplomat këtu në ambasaden greke, dhe sollni për të vizituar të shoqen në të njëjtin spital - të Feligerit - ku ishte dhe

Petriti. Një ditë shoku Dhimitër Karanxha, ishte atëherë atashe shtypi në ambasaden tonë të Vjenës e merrej edhe me të sëmuret që vinin nga Shqipëria, kur shkoi në spitalë, pa se Petrit Çobani që takuar dhe bisedonte me Ilija Paspasin. Për këtë Dhimitri më informoi mua dhe unë njoftova menjëherë me radiogram shokun Jonuz Mersini, i cili ishte drejtor i Drejtorisë së Zbulimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përveç kësaj, në një rast pas 10-15 ditësh, unë shkova për ta parë Petritin. E kërkova nëpër dhoma por nuk e gjeta. Më në fund duke kërkuar pashë se ishte i ulur vetëm për vetëm me një? E pyeta: po ku je more, se më ranë këmbët duke të kërkuar? Më tha ja dua një çikë e po bisedoj me këtë.....? Flisnin rusisht. Se ç'ishte ajo..... unë nuk e di. Për këtë rast unë nuk informova se nuk e vlersova.

istrisë së Punëve të Brendshme, me shokun Feçorr Shehu. Ai më tha: ishte të shoku Kadri dhe bisedoje, nuk kishte mundësi të

me porosi të Sami Muhametit, kur të gjitha makinat e tjera bliheshin sipas porosive që vinin në rrugë zyrtare nga Shqipëria. Shoku Kadri më tha se për këtë ke shumë të drejtë.

Kur u takova rastësisht në korridorin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me shokun Feçorr, ai më përmendi edhe çështjen e makinës dhe më tha se ajo puna e makinës qëndron, po llapin njerzit.

Shokut Kadri i kam thënë atëherë se nuk më pëlqen afiniteti që kishte shoku Feçorr Shehu me M.T., ndaj të cilit më vonë Partia ka marrë masat si njeri imoral, sidomos për marrëdhëniet....që ka pasur me vajzën e..... me të cilën u kap.....? M.T., edhe pse u dënua, vazhdon përsëri të vejë në shtëpinë e kësaj..... e cila jeton në një apartament afër banesës sime. Këtë e kam parë dhe vetë". Lidhur me të gjitha këto, shoku I.N. ruan mendimin se shoku Feçorr Shehu është hakmarrë ndaj tij dhe atij ia dedikon kryesisht masat që u muarrën ndaj tij pas kthimit nga Vjena. Në fakt, ai u ndëshkua me masë nga Partia dhe u trasferua nga Tirana sepse kishte sjellë shumë plaçka nga jashtë shtetit, për çka u aplikuan edhe taksa doganore. Pasi doli në pension u kthye përsëri në Tiranë. Para një viti ka pësuar tronditje psikike, është kurrar dhe është qëtesuar. Por përsëri ka momente nga të vuarjes nga mania e persekutimit.

Për sa i përket çështjes së autovejtës, edhe unë e di që shoku Feçorr Shehu është kritikuar. Por më bën përshtypje se edhe makina që ka marrë kohët e fundit është e një porositje të veçantë, ndryshe nga ato që kanë Ministrat e tjerë, ndonëse janë të një marke.

disa emra i kemi dhënë me iniciale, pasi ata janë rastësorë apo viktimë të indoktrinimit, intrigave dhe luftës për pushtet në klanet e udhëheqjes së lartë komuniste të asaj kohe.



Ambasada shqiptare në Vjenë

por nuk e gjeta. Më në fund duke kërkuar pashë se ishte i ulur vetëm për vetëm me një? E pyeta: po ku je more, se më ranë këmbët duke të kërkuar? Më tha ja dua një çikë e po bisedoj me këtë.....? Flisnin rusisht. Se ç'ishte ajo..... unë nuk e di. Për këtë rast unë nuk informova se nuk e vlersova. Kur erdhni në Shqipëri pas Plenumit të V-të Komitetit Qëndror të Partisë më 1975, reagova dhe kërkova takim me Ministrin shokun Kadri Hazbiu. Pasi më dëgjoi për të dy këto raste për Petrit Çobani, shoku Kadri më porositi që të bëja një shënim operativ të cilin unë e bëra. Me sa kuptova unë, ky shënim i kishte kaluar shokut Feçorr Shehu, sepse më porosi të tij erdhni në Drejtorinë e Zbulimit e më takoi shoku Lirim Pëllumbi. Ai më pyeti se kush ka dëgjoi për këtë problem? Unë i thashë se për takimin e parë ka dëgjoi Dhimitër Karanxha dhe drejtorja që unë e njoftova me radiogram, ndërsa për rastin e dytë, asnjëri. Këto, ia thashë atij, ia kam thënë dhe shokut Kadri Hazbiu. Kaq biseduam me shokun Lirim Pëllumbi.

Tre-katër ditë pas bisedës me këtë shok, rastësisht u takova në korridorin e Min-

POSTFESTIVALI

Edhe te “Gomari i Babatasit” ka tepri të tilla duke aktualizuar gjer edhe godinën e sotme të Teatrit Kombëtar, çka më kujtojnë ato të ashtuquajturat e dikurshme “Gazetat folëse të partisë” (estradat). ...

JOSIF PAPAGJONI:

“Shfaqja më e mirë e festivalit? Kishte regji, jo aktrim!”




Josif Papagjoni*

“Vdekja e Dantonit” në lupën e kritikut, kur trupa lë ‘vetëm’ regjisorin

...Çdo festival, në thelbin dhe tërësinë e vet është një FESTE, pra një takim artistësh i shoqëruar me ngazëllimin e krijimeve të shoqësoqit. Por është dhe një garë vlerash, ballafaqime përvojash, pranëvënies stiles, mënyrash të konceptuarit, metodash teatrore e regjisoriale, gjer dhe profiresh e individualitetesh. Festivali i këtij viti i teatrove të hapësirës kombëtare - Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi - solli 14 trupa me 14 shfaqje të natyrave e dimensioneve të ndryshme. U lakua shpesh se ishte festivali i rinisur pas 20 vjetësh. Jo! Në 2005 ishte i fundit. Dhe pikërisht këtu, në Tiranë. Por 13 vjet pa bërë një festival teatrosht është kohë e gjatë. E për çfarë konkurrimit, çfarë nxjerrjesh në spikamë a ballafaqimi përvojash mund të flitet në këtë ndërmjetme kohore ku dhe kur harrohet shumëçka?! Prandaj dhe kërkesa e shprehur aq shpesh edhe më parë, për të bërë një festival të vijuëshëm, të rregullt, të institucionizuar - ose në Tiranë, ose radhazi në tri qendrat e mëdha urbane të shqiptarëve, Tiranë, Prishtinë, Shkup - është një kërkesë që koha e ka vendosur herët mbi tavolinën e komunitetit teatror. Një festival me një status e marrëveshje mes tri ministrive të Kulturës së shteteve gjeëgjëse.

NEVOJA PËR FESTIVAL

U shqiptua kjo dëshirë nga shumë vetë, u lakua nga drejtorit i Teatrit Kombëtar, regjisorit Hervin Çuli, u mbështet haptazi edhe nga ministria e kulturës Mirela Kumburo. Bukur! Por fjala duhet mbajtur se! Me sa mbaj mend unë, kështu është thënë përherë, qysh nga festivali i parë i quajtur “mbarëkombëtar” i vitit 1993, kur ende shpessa shijohet e përtypej plot shije e lezet nga gjithkush prej nesh, gjer dhe kur breshërimat e automatikëve shurdhonorin veshin e gjithsesi bëhet teatër, madje festival... Pra, ka ardhur koha, më në fund (të fundit!), që të bëhemi seriozë dhe mos të tolllovitemi ende me rrena, iluzione, premtime, gënjeshtër për veten dhe për të tjerët. Kjo kërkim jo ilafë e premtime të dhëna pa tekfil e studim,



Çfarë shkoi e çfarë çaloi te shfaqjet që morën çmime dhe ku teksti kishte tepri

por projekt, para, fonde, buxhet të paraparë dhe të fiksuar në zërat gjeëgjës të Ministrisë së Kulturës, si dicka që nuk diskutohet më, por rri e ngulitur; që ËSHTË. Dhe kur “është”, domethënë duhet të bëjmë një punë paraprake përzgjedhëse, që ç’na del përpara; ngarkohet një selektor a një juri paraprake që rekomandon shfaqjet më të mira. Doemos edhe paralajmërohen kritikat e festivalit. Sepse edhe te ky festival ka, gjithsesi, një pauzidise: drama nga repertori botëror dhe drama nga autorët tanë. Tragjedi, drama, komedi dhe farsa. Klasike apo bashkëkohore? Çfarë do parapëlqejmë? Zgjidhja

nuk është e lehtë. Ky festival tashmë u “paketua”. Po nesër? Me të drejtë u tha se kahu mund të ndryshojë: çdo dy vjet të bëhet një festival, një herë më drama shqipe e një herë më drama të huaja. Kjo duket si zgjidhja më e arsyeshme sipas meje. Ta bësh çdo vit është më e vështirë, produkti është i pakët për të përzgjedhur syresh, do të krijohen të çara e kompromise për të pranuar gjëra të paarrira, të dobëta, thjesht për efekt përfaqësimit. Gjithsesi, më në fund duhet ta ringremë traditën e bukur të festivaive, filluar nga i pari në vitin 1961. Të ngremë forumin e rrahjes së mendimit dhe kritikës ndërtuese,

dashamirëse, të drejtëshuar, që nuk lazdron e përkëdhel me epitete bajate (i madh, kolos, i shkëlqyeshëm, gjigant, vip e brofka të tjera kësisoj); që nuk nxin, monon dhe fyen djersën e shqetësimit dhe të lumturisë krijuese të artistëve, por e nxit atë për shpërfaqje vlerash, stileshe e vetjakësish edhe më të epërme; që e thotë në sy të vërtetën, haptazi, me dinjitet dhe ndershmëri dhe nuk e përgojon, as e ndyn kafeneve porsa ti këthen shpinën dhe të të nxjerrin gjuhën, një gjest ky prej tinëzakësh, zillqarësh, snobësh, frikaqësh dhe shpirtngushtësh. E them këtë se në “debatet” që u organizuan kish-te tepri “sheqeri”, lavdërime dhe pak kritikë. Sa u nis dicka nga kritiku Miho Gjini, pasoi reagimi i ashpër dhe u kërkua sërisht lustra: mos më prek që të të mos prek! Jemi mirë të gjithë, vërejtje s’ka, shfaqjet qenë të shkëlqyera, të mrekulueshme! Ah, çfarë gënjeshtërash!... Tavolina e kritikës ishte një dëshitim, ani pse diku-diku edhe u shqiptuan disa ide e vlerësime. Por që të funksionojë siç duhet, ajo lipset të institucionalizohet si forum i paguar kritikës të bukura a shjellë tramundanash; kthimi në dëshirueshëm dhe janë të paramenduar si pjesë e projektit. Mëdimi dhe vlerësimi të vijë në formë opionecash të përgatitura mirë e të argumentuara, ose të një gazete a buletini, ose të një portali a rubrike në mediet elektronike e forma të tjera. Pa kritikë serioze dhe të përgjegjshme, teatri do nanuritet me ninullat prej snobësh dhe deliriume prej provincialësh e qerthujsh të ngushtë, ku të gjithë dalin “fenomenal”, të “jashtëzakonshëm”, që barabiten e konkurrojnë teatrot evropiane!...

ANALIZA E SHFAQJEVE

Në analizën e një festivali me 14 trupa e shfaqje teatrore duhet hapësirë më e gjerë, andaj dhe do të jem i shkurtuar në vlerësimet e mëposhtme.

“Medea”-Sipas meje, nga shfaqjet më të bukura, tërësore në elementët përbashkues teatrore, ishte “Medea” nga teatri “Kujtim Spahivogli”, ku përpos përjetimit tragjik të aktore Luiza Xhuvani, fituese e cmimit si aktorja më e mirë, e cila solli një nga sipëritë e aktrimit të saj me patosin, klithmat, zhgënjimin, urrejtjen, fuqinë hipnotike dhe transhendecën (sa përmes di-

mensionit të mitit aq edhe përmes gruas së sotme në zgripin e dëshpërimit të thellë), po aq mirë ishte edhe kori që erdhi si personazh i njësuar e përplotësues, më tutje Kreonti i Viktor Zhustit, për të lavdëruar si nisje edhe Kristian Koroveshin me rolin e lajmëtarit, gjer te kostumet e trajtuara me mendim dhe në shumësi përfaqësimesh karakteriale të Sofi Karasë. Shfaqja e dytë që më la mbresë për nga përmasa dhe dramaciteti ishte “Vdekja e Dantonit” e Teatrit Shqiptar të Shkupit. Leximi regjisorial i Dino Mustafiq ishte sipas meje një sfida për regjisorët tanë. Paçka se trupa aktoriale nuk ishte siç do duhet të ishte në një shfaqje të këtij dimension (nuk përfshij këtu disa aktorë si Refet Abazi a ndonjë tjetër), Mustafiq e goditi mendjen time me parabola të lexueshme, që e abstragonin kohën dhe shkonin përtej saj. Do të kujtoja atë pjerërinë e pushtetit ku rreken të ngjiten në majë, por bien e thejtnë zverkun, e cila mbushet me gjak herë pas here nga prerja e kokave në gjatësi ose shndërrohet në një yllësi ëndrrash të bukura a shjellë tramundanash; kthimi në dëshirueshëm dhe janë të paramenduar si pjesë e projektit. Mëdimi dhe vlerësimi të vijë në formë opionecash të përgatitura mirë e të argumentuara, ose të një gazete a buletini, ose të një portali a rubrike në mediet elektronike e forma të tjera. Pa kritikë serioze dhe të përgjegjshme, teatri do nanuritet me ninullat prej snobësh dhe deliriume prej provincialësh e qerthujsh të ngushtë, ku të gjithë dalin “fenomenal”, të “jashtëzakonshëm”, që barabiten e konkurrojnë teatrot evropiane!...



dit duke e identifikuar me poturë, atletet, replikat e caktuara etj., ia ka mprehur tehun e drejtpërdrejt politik që ka. Piskatori, Brehti e gjer te Robert Uillsoni e shfrytëzonin haptazi qasjen politike në shfaqjet e tyre dhe kjo është e mirëpritur në një lexim a shqetësimit regjisorial. Por unë në satirën e Fishtës nuk shoh këtë kah kundërvënës, siç është bërë në shfaqje, me një opozitë që merr përsipër përfaqësimitin e të shëndetshmes. Vallë vërtet e tilla është opozita në parlamentin tonë? Mendja mua do të më rrihte në shumë si Fishta, që edhe atë kinse "opozitë" ta shihja në lllonin dhe sahanin e korrupsionit, siç bëhet në fund të shfaqjes kur opozitë dhe opozitë ndërallan se toku në ushqim, përfaqime e pije. Te kjo kahje mund të gjendej një mënyrë tjetër e paraqitjes së ligjëritimit denoncues, sikundër "kori i instrumenteve" mund të vihej edhe me shumë në funksion muzikor, ironik dhe tallës në bashkëshoqërim, ndoshta, të veprimit të deputetëve. Gjithsesi, shfaqja kishte energji, ndërveprim kjo falë aktorëve dhe ngulmit regjisorial.

"Kaligula" - Për shfaqjen e Teatrit Kombëtar të Prishtinës "Kaligula" të Kamysë do doja të diskutojta paksa. Nga pikëpamja formale, pra si gjete dhe zgjidhje regjisoriale të mirëfillta që burojnë dhe nuk burojnë nga teksti, si veshje dhe si vezullim teatror, unë rishtazi e shoh regjisorin Kushtrim Koliqi në spiralen e tij ngjitesë drejt paradigmatve teatrorre moderne. Por kërkimet e tij më shqetësuhan dësi, pasi m'u dukën përtej tekstit, ose të shprehem më qartë, "kundër" tekstit dhe domethënies që buronte aty. Kamy shtron te "Kaligula" problemin e dhunës, shkaku pë ajo nuk ndalet, pse gjallon, pse nuk resht. Kaligula dhunon se egoja e tij e tejkalon

cakun, barabitet me gravitetin kozmik. Ai kërkon që t'i sjellin hënën, t'ia zbresin poshtë. Shikoni çfarë përmasë arrin absurdit i mendjes dhunuese! Kaligula e di se të gjithë janë të përlur, e pranojnë dhunën e tij, pushtetin e cacak, poshtërimin turpërues. Dhe nuk ngrihen dot. Askush nuk guxon t'ia fut shpatën e përbitimit drejt e në krahor. Pikërisht neveria e tij ndaj puthadorjes, ndaj meskinitetit të senatorëve e patricëve, ku nuk shikon kurrkund një hero, e bën atë krahas tërbimit dhe dhunës cinike ndaj tyre, edhe një njeri të mjerë, që e provokon vetë vrasjen e tij prej dikujt, por që askush dëshpërimisht s'e vret. Kjo humbell njerëzore, ky nënvizim i dehurizimit dhe absurdit, nën një qaje të thukët psikologjike në gjithë deliriumin e krimin dhe ephsit vetëvrasës, nuk erdhin në përmasën e duhur te kjo



shfaqje. Dhuna, paqca se e vrazhdët dhe gjegjësisht modelit të "Teatrit të egërsisë" së Artos e pasuesve të tij, u kuftuara vetëm te dhuna seksuale, edhe kjo tejet e përsëritur, pra e tepruar dhe pa arsytim, e kthyer në qëllim në vete. Nga gjetjet e mprehta të regjisorit ishte kalimi i "kurores" perandorake të Kaligulës nga njëri personazh te tjetri duke e përgjithësuar fenomenin e diktaturës dhe dhunës. Pra, diktatorët dhe diktaturat janë të kudogjendshme e të përherëshme, ashtu sikundër jemi ne ata që e mbajmë një regjim tiranik, e ushqejmë, e përligjim, goftë me frikën dhe pasivitetin tonë, goftë me adhurimin dhe shërbimin që i bëjmë. Te kjo shfaqje mund të diskutohet, po ashtu, nevoja ose jo e futjes së teksteve shtesë, parazitare a në funksion të theksimit të një ideje a një gjasje aktuale të tekstit të hershëm me realitetin e sotëm shqiptar etj. Ka regjisorë që e pëlqejnë këtë për ta bërë më provokuese dhe të thukët shfaqjen. Po te "Kaligula" pse duhet? Çfarë ideje shtoi ai tekst, shpesh parazitazhar dhe i një retorike jo fort të shoshur, të bukur e me shtresime filozofike? E

njëta gjë bëhet edhe me "Vdekjen e Dantonit", duke na kujtuar gjer edhe çmimet e qumështit!... Unë them se më shumë këto tekste përditësimi prishin punë dhe e bjerrin filozofinë në caqe rëndomtësie, se sa e rregullojnë shfaqjen. Edhe te "Gomari i Babatasit" ka tepri të tilla duke aktualizuar gjer edhe godinën e sotme të Teatrit Kombëtar, çka më kujtojnë ato të ashtuquajturat e dikurshme "Gazetat folëse të partisë" (estradat). Kjo ide që po e cek shkurt këtu është një problem i rrahur kaq shumë në katedrat e mendimit regjisorial botëror fill me shfaqjen e modernizmit në fillimin e shekullit që shkoi, kur tekstet klasike dhe të ashtuquajtura të "shenja" u goditën ballazi me rismenatizime a shtesa teksteve të drejtpërdrejta. Unë nuk jam aspak kundër kësaj mënyre a mjeti regjisorial, por me sens, masë, takt, bukuritë ligjëritim, domethënie, filozofi. Çdo gjë e prishme dhe e beftë, kur teprohet, humbet...

Si lexim regjisorial m'u duk interesant dhe i vizatuar mirë nga pikëpamja e mizanskenës dhe imazhit, ai i Kushtrim Bekteshit në dramën e tij "Ata që ikin", në teatrin e Prizrenit. Trajtimi dhe lëvizja e korit, ndërkaljet mes të vdekurve dhe të gjallëve duke krijuar një farë mistike, e pasuar nga dhimbja, pendesa, fataliteti, dashuritë e parealizuara e të dështuara, me njerëz nën trysni dhe trauma të patejkalueshme që ushqejnë krimin dhe vdekjen, këto e domethënie të tjera e bënë këtë shfaqje të mirëpritur për mua. Sigurisht duke kërkuar më shumë qartësi në linjat e subjektivitetit, më shumë identitetet në disa personazhe dhe një të folur më të qartë nga aktorët dhe të përcjellur më të mirë të spektatori. E një linjë të qetë, pa zhurmë, e tipit "cehiovian" ishte regjia e Spiro Dunit në shfaqjen "Babai" e Zellerit nga teatri i Elbasanit. Të duket nganjëherë se e zakonshmja, e rëndomta, e përditshmja, "shtëpiajka", me një mori episodesh të montuara si në film, i japin tonin kësaj regjie. Ndoshta po. Ndoshta mund të diskutohet paksa dhe në raportin e thjeshtë-thjeshtëzimit. Por ishte fuqia e talentit të Reshat Arbanës në rolin kryesor që shfaqja u ngrit aq lart, u përligj si e tillë. Ishte një nga kurorat meritorë të fundkarrierës artistike të këtij aktori të

shquar të skenës dhe ekranit tonë. Qe një rol i mbajtur thellë, gati si në humbëtitat e pavetëdijes së shkatërruar tashmë nga lodhja e jetës, fatkeqësitë, mërzitë dhe sëmundja. Një çmim plotësisht i merituar si aktori më i mirë i festivalit. Edhe në trajtimin e tekstit elegant "Qielli i heshtur" nga Armeta Demaj në teatrin e Metropolit u pa po një tipologji e tillë regjisoriale, ku na vjen ëmbël pasioni për punën, i pleksuar me dashurinë dhe nostalgjitë që burojnë prej saj. Aty-aty ishte dhe shfaqja e Fierit "Dy dyzina me trandafila", nën një lirike të ëmbël nga aktorja Doriana Çausi, ku muguillim i ertosit të përfytyruar në shpirtin e qdo femre krijtoje një mistikë të bukur, dikja e patrajtë, efemere, për një arrati apo aventurë të munguar e ngazëllyese diku, dikur... Nëse nga pikëpamja aktoriale shfaqja e teatrit të Vlorës "Senatori Foks" ishte e pastër dhe me rolet e Astrit Mamajt dhe Jorgaq Tushes krijoi vetëbesim, mua më la të paplotësuar teksti me navitetet e tij të një lëtrësie sentimentaliste, romantizante, madje naive e të tejkualuar prej herit, çka e dobësonte dukshëm mesazhin e saj; korrupsionin e elitave të pushtetit. Drama "Vetëvrasësi" e teatrit të Korçës dhe Teatrit Kombëtar ishte një tekst i përgjigdhur saktë, me ide që na kujtojnë absurdin e viteve të diktaturës dhe ku spikati veçanërisht loja e Neritan Liçajt e shoqëruar me disa tipa e karaktere të punuara me kujdes nga Elia Zaharia, Zamira Kita, Albano Prodani. Ndërsa shfaqja e teatrit të Gjirokastrës duhet vlerësuar se nxori nga sirtarët dhe shkundi nga pluhuri i harrësës një emër të njohur të historisë së dramës shqipe, Et'hem Haxhiademin, me tragjedinë "Pirrua". Por kur e vë në peshoren e trupave të tjera, ajo la shumë për të dëshiruar, sikurse drama e teatrit shqiptar "Teuta" e Malit të Zi thuajse me po këtë prerje sentimentaliste e naive. Nuk rri dot pa thënë dy fjalë inkurajuese edhe për regjisorin e Andia Xhungës në komedinë "Tag" të Bashkim Hoxhës nga Teatri Kombëtar, e cila duket se e bëri më të hareshme duke e tejkualuar tekstin me gjetjet e saj të këndshme, me ngulmimin në karaktere, ku unë do të veçoja posaçërisht Adelina Muçën, Olta Dakun dhe Indrit Çobanin. Por do të mendoja se ky teatër mund të përfaqësohej me një vepër me dinjitoze e më të arrirë, pasi në raport me trupat e tjera nuk shënoi, të themi, një "ngjarje" a një përvojë për t'u marrë si shembull nga të tjerët.

***Kritik teatri, anëtar i jurisë së Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit. Titujt dhe detajet janë të redaksisë**

DRIANT ZENELI PËRFAQËSON SHQIPËRINË NË EKSPOZITËN NDËRKOMBËTARE TË ARTIT NË VENECIA

Shqipërisë në Ekspozitën e 58-të Ndërkombëtare të Artit - La Biennale di Venezia - me projektin me titull "Maybe the cosmos is not so extraordinary" - "Ndoshta kozmosi nuk është aq i jashtëzakonshëm", nën kurimin e Alicia Knock, kuratore në Qendrën "Pompidou" në Departamentin e Artit Bashkëkohor, në Paris. Titulli merr shkas nga romani fantastiko-shkencor i autorit shqiptar Arion Hysenbegas, "Drejt Epsilonit të Eridanit", i botuar në vitin 1983 (ribotuar i plotë në vitin 2018).

Driant Zeneli (lindur në Shkodër, 1983), jeton dhe punon mes Tiranës dhe Milanos. Vepra e Driant Zenelit sfidon limitet intelektuale dhe fizike, duke vendosur në skenë dhe duke performuar situata sureale dhe ironike,



ndonjëherë dhe absurde. Shpesh puna e Zenelit identifikohet me ëndrrat, luan me arsyen, ndërkohë që ndërvepron me publikun. Në qendër të veprimit performativ, si dhe në punët e tjera të artistit ku përdoret gjuha e narrativës filmike, ndodhet ripërkufizimi i dështimit - si çasti themelor për të krijuar një alternativë të re. Në vitin 2008 Zeneli fitoi çmimin Ndërkombëtar "Onufri" në Tiranë dhe në vitin 2009 çmimin "The Young European Artist Award", Trieste Con-

temporanea. Në vitin 2017 ai fitoi çmimin "MOROSO", Itali. Driant Zeneli ishte drejtor artistik i "Mediterranea 18", "Bienalla e Artistëve të Rinj nga Evropa dhe Mesdheu", që u zhvillua për herë të parë në vitin 2017 midis Tiranës dhe Durrësit. Ai është, gjithashtu, bashkëthemelues i Platformës së Artit Bashkëkohor Harabel në Tiranë. Disa nga ekspozitat e tij janë zhvilluar në: Passerelle, Centre d'Art Contemporain, Brest, (2018); Mostyn Gallery, Wales, UK (2017); MuCEM, Marseille, UK (2017); Centre Pompidou, Paris (2016); GAM, Museum of Modern and Contemporary Art Turin (2013); ZKM, Karlsruhe (2012); MUSAC, Castiglia León, Spain (2012); Prague Biennale 5 (2011).

Opinion i Ditës

Xhisiela i ka mërzhitur të gjithë

Nga Astrit Patozi

(vijon nga faqja 1)

... e cila po shërben si pasqyrë për të shquar fytyrën e deformuar të një shoqërie të përdhunuar dita-ditës në grup. Kanë gati një javë që janë vërsulur mbi të, duke e shqyer nga të gjitha anët, në garë me njëri-tjetrin se kush të përfitojë më tepër, sa jam i sigurt se e kanë vrrarë aq shumë, sa nuk e teproj po të them se Rexhepi, i vetmi që ka shkuar deri tani në burg, ngjan të jetë përdhunuesi më i vogël.

QEVERIA

Xhisiela ishte star mediatik mbrëmë, kryesisht për të zezen e atyre që e kishin dërguar me pahir, apo që, në rastin më të mirë, qëndronin prapa saj, duke mbajtur frymën pas çdo fjalie që thoshte.

Ata janë shumë të mërzhitur me vazhën, sepse sado e vendosur që ishte për të mbrojtur dhunuesin e vet, pa iu dridhur qerpiku që rrezikonte burgun, avokatia e saj e nxori më në dritë krimin e shëmtuar të "rilindasit të vogël". Ajo foli gjatë në fakt, por në përpjesëtim të drejtë me heshtjen e babait të agresorit dhe pikërisht këtu duhet kërkuar e vërteta. Lodhen kot ata që kërkojnë përputhje dhe mospërputhje dëshmish në procesverbalet e policisë dhe të tjerët që duan të gjejnë "heronjtë" dhe "dajjtë" shtetërorë të kësaj historie të dhimbshme.


Qeveria ngjan dukshëm të jetë në hall, por jo për detajet dhe personazhet, me të cilat po furnizohet pa mëshirë publiku prej disa ditësh. Të cilat as i shtojnë dhe as i heqin ndonjë gjë të madhe kësaj drame njerëzore.

Në fakt, gjëja më e rëndë këtu është fakti që një deputeti të parlamentit, pas gati dy vjetësh në atë detyrë, i mësuam emrin thjesht dhe vetëm për shkak të djalit që kishte dhunuar dhe torturuar mizorisht një vajzë jetime. Dhe e gjitha kjo ndodh, pas aplikimit të ligjit të dekriminalizimit, prej valës së parë të të cilit kishin rënë "dëshmorë" shumë emra të famshëm të "Rilindjes".

Këtë provë ulëritëse, që po përpiqeshin ta fshihnin me zor, të gjithë avokatët e qeverisë, e dekonspiroi me një fjali të vetme djali i deputetit socialist, i cili paralajmëroi se hakmarrja e tij do të binte mbi kokën e opozitës në zgjedhje, duke zbuluar kështu edhe në një farë mënyre arsyen pse babai i tij është sot deputet. Ishte një reagim i singertë që buronte nga subkoshienca, i cili me siguri që i ka shoqëruar shumë shefat e "Rilindjes", që nga strategu suprem, që shtrëngon timonin, e deri tek ndihmësit e vet që kurojnë imazhin e rënuar të qeverisë së tij.

OPOZITA

Por ne prej shumë vitesh kemi një opozitë, që është aleatja më e mirë e qeverisë, edhe kur nuk do të jetë e tillë. Sepse asaj nuk i mjafton asnjëherë e vërteta, edhe kur ajo është në anën e saj, ngaqë



përpiqet t'i imponojë publikut versionin e saj për ngjarjen, edhe kur mungojnë fare faktet dhe provat. Duke lënë mënjanë humanizmin e munguar ndaj një vajze të dhunuar dhe kujdesin që duhet të kishte për të mos e lënduar më tej një viktimë, sepse janë luks i tepërt për ambientin e helmuar politik në Shqipëri. A ka njeri me logjikë në Shqipëri që të shpjegojë se përse duhet që bashkë me dhunuesin e vajzës të ishin patjetër edhe disa eksponentë të Partisë Socialiste? Sepse e përjashtoj kategorikisht mundësinë që kjo mund të bëhet për ta relativizuar ngjarjen dhe për t'ia bërë më të lehtë kundërshtarit hallin.

Ndërkohë që përfshirja e djalit të deputetit socialist dhe e gjithë

kronologjia për të fshehur krimin ishin të mjaftueshme për të ngritur një kauzë të fortë. Duke haruar që çdo teprim apo ekzagjerim vetëm se bën pis edhe vetë të vërtetën, për të cilën nuk ka askush dyshim në Shqipëri. Njësoj si në rastin e vëllait të Fatmir Xhafajt, për të cilin mjaftonte vendimi i gjykatës italiane që ishte i dënuar për trafik droge dhe ishte krejtësisht i panevojshëm skenari i përgjimit me Babalen.

Ndaj sot ata që paguhen për të qenë opozitë janë të mërzhitur me Xhisielën, jo pse nuk po qëndronn variantit të parë të padisë, ndërkohë që e kuptojnë edhe zogjtë në Shqipëri që ajo është peng, por pse nuk po thotë dhe ajo si ata, se kur e rrahën, bashkë me agresorin

ishte edhe Taulant Balla, Gramoz Ruçi, Erion Braçe, Edi Rama, madje edhe Xhorxh Sorosi.

Por nëse e duan Edi Ramën patjetër të përfshirë në ngjarje, nuk ka nevojë ta çojnë në komisaratin e Fushë-Krujës. E kanë aty brenda që nga dita e parë, kur ka zgjedhur deputet babain e Rexhepit, e deri më sot që i shkruan tekstin e "Facebook"-it dhe interesohet për çdo detaj të kësaj qenërie, me synim që "Rilindja" të dalë sa më pak e cenuar nga kjo histori.

MEDIA DHE SHOQËRIA CIVILE

Meqë palët ndërluftuese të politikës në Shqipëri e kanë treguar në vijimësi që nuk kanë limite në ndonjë mënyrë të shprehjes së tyre, nuk ishte ndonjë çudi që kujdesi, mëshira dhe empatia për viktimën të mos pritej prej tyre.

Për fat të keq, vajza e dhunuar u trajtua si kavie edhe nga shtypi apo dhe gërmadhat e shoqërisë civile, që kanë mbetur në këtë vend. Diku për ca klikime më shumë, diku e përfshirë nga tifozëllëku politik, diku nga ethet e protagonizmit, për të mos shkuar më larg, fati i vajzës dhe mbi të gjitha ajo që përfaqëson drama e saj, u konsiderua si gjë pa vlerë në raport me audiencën e një dite apo konkurrencën brenda llojit. Mund të ketë shumë punonjës të medias dhe aktiviste të mbrojtjes

së të drejtave të grave që janë mërzhitur mbrëmë me Xhisielën. Disa e kanë dashur të ishte më trimë, që të denonconte me kurajë dhunuesin e vet, disa më të mençur, që të mos kishte kontradikta të forta në rrefimin e saj, disa që të mos kishte humbur 12 kg në një muaj, por një cikë më pak.

Më të dhembshurit prej tyre i kanë gjetur edhe zgjidhjen, të kërkojë strehim politik në një vend demokratik, a thua se Xhisiela dhe mijëra gra dhe vajza që kanë histori të ngjashme me të e dëgjojnë për herë të parë këtë opsion.

Mbrëmë isha i trishtuar, kur shikoja se si e shëtisnin vajzën nga një ekran në tjetrin dhe përfytyroja ata që kishin dhënë lejen dhe të tjerët që e shoqëronin atë edhe fizikisht. Por sot mendoj, se më mirë që Xhisiela foli, edhe pse qëllimi i atyre që ia dhanë atë mundësi ishte tjetër.

Është cinike ta thuash, por kam bindjen se drama e fortë njerëzore e një vajze të brishtë nga Fushë-Kruja na shërbeu të gjithëve për të kuptuar se jemi kthyer dalëngadalë në një shoqëri që ushqen dhunën në të gjitha format e saj. Një vend që u falet dhe u përulet "të fortëve", të cilët jo domosdoshmërisht janë të ngjashëm me "rilindasin e vogël" Rexhep.

Opinioni *i* Ditës

Pse dështoi referendumi në Maqedoni?!

Nga Naser Pajaziti

(vijon nga faqja 1)

... së Prespës. Rezultati ishte një fiasko prej vetëm 36%, duke mos arritur censusin e nevojshëm mbi 50% nga 1.8 milionë votues.

Janë shumë elemente të njohura dhe me pak të panjohura rreth asaj se çka çoi në dështimin e referendumit.

-Mospastrimi i listës së votuesve ka vështirësuar arritjen e rezultatit pozitiv, pasi që është konsideruar absurde, Maqedonia me mbi 2 milionë banorë të ketë 1.8 milionë votues. Edhe pas shumë përpjekjeve lista e votuesve nuk është pastruar, pasi në të vijojnë të jenë votues fiktiv dhe të vdekurit, që nuk janë shlyer me vite të tëra, në mungesë të regjistrimit të popullsisë.

- Bojkotimi i thirrur nga opozita ishte një element kyç që çoi në abstenimin e madh të qytetarëve, sidomos anëtarësisë së VMRO-DPMNE-së. Por bojkotit i shtohen edhe thirrjet aktive dhe propaganda në internet e grupeve joformale që edhe publikisht kanë shprehur qëndrimet proruse, siç është një parti minore "United Macedonia".

- Vetëmashtrimi dhe krijimi i bindjes nga kryeministri Zoran Zaev dhe aleatët e tij qeveritar se referendumi do të jetë i suksesshëm dhe do të arrihej censusi i nevojshëm. Megjithatë me 605 mijë votat "PËR", Zaevi e shpalli të suksesshëm referendumin, pasi që sipas tij, këto vota nuk ka arritur t'i sigurojë asnjë parti apo kandidat për president në zgjedhjet e organizuara nga pavarësimi i vendit.

- Një element tjetër është se partitë pro referendumit e shfrytëzuan fushatën më tepër me qëllime dhe ngjyrimë partiake, sikur të ishte ndonjë fushatë



zgjedhore, me një propagandë të gabuar

- Efektin negativ e kishte edhe largimi i vazhdueshëm i shumë qytetarëve drejt vendeve të BE-së, për shkak krizës sociale dhe ekonomike në heshtje që po merr përmasa shqetësuese. Por kësaj i shtohet edhe bojkoti dhe mosinteresi i madh nga diaspora për të mos dalë në votime.

- Një grup i caktuar i qytetarëve ka gjetur arsyet duke mos qenë i

kënaqur me qeverinë aktuale, e cila në të shumtën e rasteve është kritikuar për qasjen e saj kryesisht ndaj procesit të eurointegritimeve dhe zgjidhjes së kontestit të emrit dhe më pak të fokusuar në çështjet e brendshme në planin social dhe ekonomik.

Me gjithë këtë, referendumi ishte konsultativ dhe se barra kryesore i kalon Kuvendit ku duhet të sigurohen 80 deputetë për t'i dhënë dritë jeshile Mar-

rëveshjes së Prespës, si një tentim i dytë për të çuar vendin në NATO dhe BE. Partitë e koalicionit qeverisës bashkë me partitë shqiptare kanë 71-73 deputetë, por duhet që të sigurohen edhe votat nga kampi i deputetëve të opozitës maqedonase. Kryeministri Zaev është shprehur i bindur se do të vazhdojë misionin e tij për anëtarësimin e vendit në NATO dhe BE, derisa opozita kërkojë pensionimin e tij nga politika.



HOROSKOPI

DASHI

Mos lejoni që një person pa të drejtë t'ju kritikojë dhe t'ju pengojë në arritjen e rezultateve të mira në biznes. Përpuni që të kontrolloni krenarinë tuaj, në vend që të bëni gara me të tjerët.

DEMI

Keni nevojë të domosdoshme për qetësi familjare dhe për mirëkuptim të partnerit, në mënyrë që ta harmonizoni ritmin tuaj dhe të realizoni balancën e plotë emocionale.

BINJAKET

Jeni duke u sjellë me përgjegjësi të mëdha ndaj bashkëpunorëve dhe nuk lejoni që askush t'ju ndryshojë ritmin apo planet. Bashkëpunorët kanë besim të mjaftueshëm në dijen dhe aftësitë tuaja.

GAFORJA

Nëse ndjenjat tuaja mund t'i harmonizoni me veprimet të arsyeshme, do të jeni edhe më shumë të sigurt. Zbukurojeni jetën tuaj dashurore, përpuni që të silleni me entuziazëm dhe në mënyrë joshëse ndaj personit të dashur.

LUANI

Nëse dëshironi që t'i realizoni sukseset në planin financiar, ju nevojitet një përqendrim i mirë. Nuk ka arsye t'i mbivlerësoni aftësitë personale, ekzistojnë situata, të cilat e kapërcëjnë dijen dhe përvojën tuaj praktike.

VIRGJERESHA

Nëse vërtet dëshironi të pajtoheni me personin e dashur, vini në funksion aftësitë tuaja sekrete, në mënyrë që të lini përshytyje te personi i dashur. Bëhuni të zgjuar dhe krijoni një strategji për çështjet e dashurisë.

PESHORJA

Nëse idetë tuaja i paraqitni në një mënyrë interesante, mund të prisni reagim pozitiv dhe përkrahje nga bashkëpunorët. Është mirë të planifikoni detaje të ndryshme, të cilat do të ndikojnë pozitivisht.

AKREPI

Duket se kërkonit të keni një romancë dashurore. Do ta arrini nëse i përdorni të gjitha dhuntitë tuaja dhe aftësitë joshëse. Me financat, gjithashtu, gjërat janë në drejtimin e duhur.

SHIGJETARI

Jeni duke luftuar për të arritur pozicionin sa më të mirë në planin afarist dhe po silleni në mënyrë shumë të bindshme dhe të vendosur para bashkëpunorëve. Jeni me plot ide interesante.

BRICJAPI

Duhet të angazhoheni sa më mirë në sjelljet tuaja, të tregoni më shumë kujdes në takime të ndryshme dhe para sfidave emocionale. Ekzistojnë mundësi, që dikush të zbulojë qëllimet tuaja sekrete.

UJORI

Nuk po u kushtoni fare rëndësi vërejtjeve të shumta që po jua japin bashkëpunorët. Keni bindjen që jeni një hap para të tjerëve dhe që së shpejti do të arrini sukses.

PESHQIT

Për shkak të vlerësimeve të mira afariste-financiare dhe planeve të hollësishe, do të arrini rezultate të mira. Është me rëndësi që të gjitha gjërat t'i keni nën kontroll.

LIGA E KAMPIONEVE

Juventus ka marrë fitoren e dytë në grupin H, pasi ka mposhtur me rezultatin e pastër 3-0 skuadrën zviceranë të Jang Bojs. Bardhezinjtë e Alegriti nuk kanë vënë për asnjë moment në dyshim marrjen e tri pikëve, edhe pse ishin pa Ronaldo në fushë. Roli i liderit në sulm iu besua Paolo



Dibalës dhe argentinasi nuk zhgënjëu. 24-vjeçari shënoi tri gola, duke bërë një ndeshje perfekte. U duk se Dibala shprehu të gjitha aftësitë e tij në momentin kur është kritikuar më së shumti. Juve merr kreun e grupit H pas dy javësh, në kuotën e 6 pikëve. Guardiola shpëtoi nga yjet e tij, pasi emra si Aguero dhe David Silva e treguan veten e tyre në arenën më të madhe të

Juventus 'fluturon' me Dibalën, Siti gjen fitoren e parë

futbollit për klube. Edhe pse Siti ishte shumë shpejt në disavantazh në transfertën kundër Hofenheim, me vendësit që shënuan që në minutën e parë të takimit, arritën të kundërpërgjigjeshin dhe të merrnin pikët e para në grupin F. Pas humbjes kundër Li-

onit në "Etihad Stadium", pritej reagimi i "Qytetarëve" dhe fitorja erdhi. Aguero në minutën e 7 të takimit dhe David Silva vetëm 3 minuta nga fundi i sfidës i siguruan tri pikët skuadrës britanike në transfertën e vështirë gjermane.

Italiani vijon të mos i besojë Kategorisë Superiore, vetëm portieri Alban Hoxha i grumbulluar



Jeton Selimi

Risi dhe përjashtime në listën e Panuçit

Jashtë Agolli e Hyja, 4 debutues thirren 'nën armë'

Dy përjashtime dhe katër risi në listën e Kristian Panuçit për dy ndeshjet e radhës të përfaqësueses kuqezi. Pasditën e së martës, tekniku italian ka publikuar emrat e grumbulluar për sfidat ndaj Jordanisë dhe Izraelit, ku spikat mungesa e Ansi Agolli dhe Jahmir Hykës, dy kapitenët e fundit në sfidat e shtatorit, me të parin që nuk u aktivizua në asnjërin prej tyre, por që e pa shiritin në krahun e Hykës dhe Hysajit. Por përkundër përjashtimeve, nuk mungojnë as befasishtë me Panuçin që ka thirrur për herë të parë nën armë Xhakomo Vrionin, Myrto Uzunin, Kastriot Demarkun dhe Egli Kajën, të cilët do të shpresojnë të kenë në dispozicion minuta në miqësoren ndaj Jordanisë në datën 10 tetor. Katër ditë më pas ndaj Izraelit do të luhet për pikë dhe hapat fals janë të ndaluar, ndaj Panuçi do t'u besojë lojtarëve ekspertë.

PROBLEMATIKA

Dy janë telashet më të mëdha që duhet të zgjidhë Panuçi dhe Federata Shqiptare e Futbollit. Rasti i parë ka të bëjë me Kastriot Demarkun, që mund të shndërrohet në një mollë sherri me Federatën e Kosovës, pasi mbrojtësi i Kozencës ka qenë i grumbulluar më herët nga Kosova.



Dermaku është një lojtar me eksperiencë dhe ka qenë vetë trajneri i përfaqësues së Kosovës, Bernard Shalandez, ai i cili e ka konfirmuar largimin e tij. Kujtojmë që Dermaku

është monitoruar që në kohën kur përfaqësuesen tonë e drejton trajneri italian, Xhani de Biaz. Madje, Dermaku ka luajtur edhe në një ndeshje miqësore me përfaqësuesen U-

21 të Shqipërisë, por ka pasur edhe një marrëveshje mes dy federatave, që të mos ndërhyjnë në radhët e skuadrave respektive për të marrë lojtarë, por me sa duket, me ndarjen

nga jeta të Fadil Vokrri, kanë filluar edhe lëvizjet e para. Por telashe ka edhe për Xhakomo Vrionin, talenti i Shpresave që ka marrë tështë zyrtare nga trajneri i Kombëtares së Sh-

CHAMPIONS LEAGUE

TE MARTEN

GRUPI E

AEK Athinë – Benfika 2-3
 Bajern Mynih – Ajaks 1-1

Grupi F

Hofenheim – Man.Siti 1-2
 Lion – Shakhtar Donjeck 2-2

Grupi G

CSKA Moskë – Real Madrid 1-0
 Roma – Viktora Plzen 5-0

Grupi H

Juventus – Jang Bojz 3-0
 Man.Junajtid – Valencia 0-0

TE MERKUREN

Grupi A

Atletiko Madrid – Bryzh 21:00
 Borussia Dortmund – Monako 21:00

Grupi B

PSV Ajndhoven – Inter 21:00
 Tottenham – Barcelona 21:00

Grupi C

Paris SG – Crvena Zvezda 18:55

Grupi D

Lokomotiv Moskë – Schalke 21:00
 Porto – Gallatasaraji 21:00

| Nr. | EMER MBIEMER | POZICIONI | SKUADRA |
|-----|-------------------|-----------|---------------------|
| 1 | THOMAS STRAKOSHJA | PORTIER | SS LAZIO |
| 2 | ETRIT BERISHA | PORTIER | ATALANTA BC |
| 3 | ALBAN HYSAJ | PORTIER | FK PARTIZANI |
| 4 | ELSED HYSAJ | Mbrojtës | NAPOLI |
| 5 | EGLI KAJA | Mbrojtës | LIVINGSTON |
| 6 | ERMIR LENJANI | Mbrojtës | SION |
| 7 | EGZON BINAKU | Mbrojtës | MALMO |
| 8 | MERGIM MAVRAJ | Mbrojtës | ARIS |
| 9 | FREDERIC VESELI | Mbrojtës | EMPOLI |
| 10 | HEDRI PRENGA | Mbrojtës | NK INTER ZAPRESIC |
| 11 | KASTRIOT DEMARKU | Mbrojtës | ATALANTA |
| 12 | BERAT DIMSITI | Mbrojtës | ATALANTA |
| 13 | ENEA MIHAJ | Mbrojtës | PANTELIKOS |
| 14 | ANDI LILA | Mesfushor | PAS GIANNINA |
| 15 | LEDIAN MEMUSHAJ | Mesfushor | PESCARA |
| 16 | YLIBER RAMADANI | Mesfushor | VEJLE BOLDKLUB |
| 17 | MIGJEN BRASHA | Mesfushor | ARIS |
| 18 | TALAJNT SHAKA | Mesfushor | BASEL |
| 19 | EMANUELE NDOU | Mesfushor | BRESCIA |
| 20 | EROS GREZDA | Sulmues | RANGERS FC |
| 21 | REY MANAJ | Sulmues | ALBACETE |
| 22 | ENIS GAVAZAJ | Sulmues | YENISEY KRASNOYARSK |
| 23 | MYRTO UZUNI | Sulmues | LOKOMOTIVA ZAGREB |
| 24 | BEKIM BALAJ | Sulmues | AKHMAT GROZNY |
| 25 | GIACOMO VRIONI | Sulmues | VENEZIA |

qipërisë, Kristian Panuçi. 19-vjeçari, që vesh fanellën e Venecias, bëri ndeshje të shkëlqyera me përfaqësuesen U-21. Por problemi me sulmuesin e ri është fakti që nuk ka pasaportë shqiptare. Prej shumë kohësh tashmë, letrat e tij janë në federatë, por pasaporta për të nuk ka mbërritur ende. Vrioni mund të luajë në ndeshjet miqësore, ashtu siç bëri kundër Italisë, por në ndeshjen zyrtare kundër Spanjës nuk mund të aktivizohet. E njëjta situatë pritet të përsëritet sërisht, pasi talenti 19-vjeçar me shumë gjasë do të luajë në miqësoren kundër Jordanisë, por kundër Izraelit që është ndeshje zyrtare, nuk ka të drejtë të aktivizimi. Ndërkohë mund të vihet re shpërfillja e vazhdueshme që Panuçi i bën Kategorisë Superiore, teksa lojtari i vetëm i grumbulluar është portieri i Partizanit, Alban Hoxha.

VLONJATI I SKËNDERBEUT

Bregu: Kukësin do ta mposhtim me ndihmën e tifozëve

Dejvi Bregu ka folur sot në një konferencë shtypi, ku ka komentuar humbjen me Teutën në Durrës, mungesën e golit dhe ndeshjen e radhës me Kukësin. Lojtari vlonjat i Skënderbeut beson se me ndihmën e tifozëve, korçarët do të kthehen te fitorja: "Humbja me Teutën nuk duhet bërë dramë, sepse ishte humbja e parë për ne në këtë kampionat. Mund t'i ndodhë çdo skuadër. Ne vinim pas një ecurie mjaft të mirë dhe më vjen keq për ekipin. Kisha një rast të mirë dhe më vjen keq që nuk



shënova, sepse ndeshja mund të kishte marrë tjetër rrjedhë, por tani duhet të shohim përpara. Mungesa e golit? Nuk më shqetëson. Besoj se me ndi-

hmën e shokëve të skuadrës, me ndihmën e stafit teknik dhe të tifozëve, do ta shënojë dhe do të ndihmoj skuadrën. Kukësi është një ekip që duhet vlerësuar, është një ekip rival dhe me potencial, por ne duhet të bëjmë më të mirën për të fituar. Shpresoj që me ndihmën e tifozëve, t'ia dalim në këtë ndeshje për të marrë 3 pikët". - ka thënë mes të tjerash sulmuesi i Skënderbeut, Dejvi Bregu, një nga titullarët më të rëndësishëm të formacionit të ekipit korçar.

REZULTATET NEGATIVE

Inate të reja të Barça, Pike është kundër Mesit


Vetëm një pikë në dy ndeshjet e fundit. Numra të ftohtë për një skuadër si Barcelona, edhe pse kryeson renditjen. Në Spanjë janë të sigurt se Barcelona zien nga brenda, pasi ka divergjencë mes lojtarëve. Sipas "El Chiringuito", ka një divorc total mes Zherard Pike dhe Lionel Mesit. Mbrojtësi katalanas nuk e pranon faktin që Mesi nuk del hapur në situata të vështira dhe flet me shtypin vetëm kur është jashtë Europës, veçanërisht gjatë grumbullimeve me



Argjentinën. Kohët e fundit "Pleshti" ka lëshuar akuzë për mbrojtjen, duke theksuar se skuadra pëson shumë gola. Një atmosferë

aspak e mirë te Barcelona, aq më tepër në prag të ndeshjes së nesërme në Champions League me Tottenhamin.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Është Aleanca ku sapo kemi aderuar.
- Kufijtje e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarat.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë.
- Preka komik shkodran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.
- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.

- Është përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Është e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë .
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Është nyja që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titanëve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Është metri i rrobaqepësit.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe te Tobias.
- Është bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Është marrëveshje me nota.
- Është babai i Akilit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Është faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Writen nga espada.
- Është shtet aziatik.
- Edouard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samurai.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtrinë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Është ngjinja.
- Ricciarelli soprano.
- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.


- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Është kolana në filmat
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Është tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

VERTIKAL


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Është edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicilat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Është tryzni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 8 | | 7 | 2 | |
| | 3 | 9 | | 1 | 7 |
| | | | | | 4 |
| | | 4 | 6 | 5 | |
| 6 | | | | | |
| | | | | | 7 |
| | | | 8 | | |
| 4 | | | 2 | | 1 |
| | 2 | 9 | 4 | 8 | 6 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 5 | 1 | 2 | 7 | 8 | 9 | 3 | 6 |
| 8 | 9 | 2 | 6 | 3 | 1 | 5 | 4 | 7 |
| 3 | 6 | 7 | 4 | 9 | 5 | 2 | 8 | 1 |
| 5 | 7 | 8 | 1 | 2 | 4 | 3 | 6 | 9 |
| 2 | 1 | 6 | 3 | 8 | 9 | 4 | 7 | 5 |
| 9 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 1 | 2 |
| 6 | 4 | 3 | 9 | 1 | 2 | 7 | 5 | 8 |
| 1 | 8 | 9 | 7 | 5 | 3 | 6 | 2 | 4 |
| 7 | 2 | 5 | 8 | 4 | 6 | 1 | 9 | 3 |

Argëtim filozofik

- Kam vërejtur se edhe njerëzit që pretendojnë se gjithçka është e paracaktuar, dhe se ne nuk mund të bëjmë asgjë për ta ndryshuar atë, shikojnë anash para se ta kalojnë rrugën. Stephen Hawking
- Sa më i vjetër që bëhesh, aq më shumë e kupton se si rastësia ka ndihmuar në përcaktimin e shtegut tuaj përgjatë jetës. Rowan Atkinson
- Në këto negociata ne nuk jemi një objekt jondihmues, ndonëse të gjitha fuqitë botërore janë përfshirë. Ne luajmë një rol aktiv dhe

KRIPTOSKEME

| | | | | | | | | | | |
|----|---|----|---|----|----|----|---|----|---|----|
| 3 | 1 | 7 | 2 | | 7 | 3 | | 13 | | 2 |
| 2 | 7 | 5 | | | 8 | 4 | 3 | 5 | 7 | 2 |
| 7 | | 3 | 1 | 9 | 1 | 6 | 5 | 10 | 6 | 2 |
| | 3 | 5 | 8 | 2 | 3 | 5 | 6 | 1 | 7 | 5 |
| 12 | 5 | 13 | 5 | 10 | 1 | 7 | | 6 | | 13 |
| 2 | 7 | 18 | | 5 | 11 | 2 | 6 | 5 | 8 | 2 |
| 8 | 2 | 6 | 2 | | 2 | | 1 | 8 | 5 | 11 |
| 1 | 6 | 8 | | 17 | 9 | 5 | 7 | 2 | | 9 |
| 3 | 1 | 5 | | 8 | 2 | 16 | | | 2 | 7 |
| 2 | | | | 3 | 2 | 6 | 5 | 9 | 2 | 1 |
| 6 | 2 | 7 | 2 | | | 3 | 7 | 18 | U | M |
| 3 | 4 | 8 | 5 | 19 | 1 | 5 | | 3 | 5 | 2 |

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | T | A | R | E | T | I | K | E | T | A | T |
| A | R | M | I | K | E | S | T | O | L | I | T |
| L | I | O | R | O | M | I | N | A | T | | |
| L | O | C | A | B | A | R | E | T | L | A | |
| A | B | A | T | E | R | I | T | E | A | R | |
| T | R | I | M | E | R | I | T | E | A | N | E |
| A | R | T | U | R | O | U | I | M | A | T | T |
| A | R | S | E | N | E | E | A | A | | | |
| A | D | A | T | M | E | T | R | I | C | | |
| P | A | K | T | P | I | R | A | T | E | R | I |
| K | U | A | L | I | T | E | T | I | E | P | |
| L | E | C | E | P | I | N | A | T | A | | |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F | E | R | M | A | N | I | T | J | N | A |
| A | K | S | I | L | O | V | A | L | E | |
| R | O | N | E | P | F | R | E | N | A | T |
| A | H | I | P | O | K | R | I | T | E | T |
| D | I | E | M | O | S | T | E | N | I | K |
| D | I | K | A | S | T | E | R | E | T | N |
| A | M | A | L | I | A | I | Z | E | N | E |
| D | E | L | E | R | A | E | O | E | | |
| A | R | K | I | E | P | I | T | E | T | E |
| I | O | M | A | I | D | M | A | D | H | I |
| S | R | I | R | I | E | L | I | R | E | N |
| T | E | R | R | O | R | I | A | R | E | N |
| L | U | I | S | S | P | A | M | A | L | I |
| A | L | K | T | R | O | B | E | R | I | A |
| P | F | E | R | I | O | D | I | K | A | R |
| P | I | N | A | L | J | A | A | A | R | N |
| R | E | P | A | R | T | E | T | S | I | T |
| T | E | R | E | K | S | I | P | N | | |
| P | A | R | E | T | T | R | U | K | E | T |
| A | R | I | T | R | E | A | L | K | U | P |
| S | T | A | N | D | E | M | N | E | R | E |
| A | H | O | T | E | L | E | T | T | R | A |
| J | U | K | A | T | E | R | | | | |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- përgjigje të ndikojmë në fatin tonë; ne i kemi letrat tona fituese dhe i përdorim ato. Alija Izetbegović
- -Unë mund të kem pasur shumë fat në jetën time, por prapë kam nevojë të përballem me sfida në ndeshjet. Zinedin Zidane
- -Zelli është prind i fatit të mirë. Benxhamin Frenklin
- -Të bekuar janë njerëzit liderët e të cilëve mund ta shikojnë fatin drejt e në sy pa iu dridhur qerpiku, por gjithashtu pa tentuar të luajnë rolin e Zotit. Henri Alfred Kisinxher

